



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 36 regjistër (JR)
Datë 29.06.2021

Nr. 19 i vendimit
Datë 09.05.2024

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 09.05.2024, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Bilo, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 370, datë 18.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe

pretendimet e paraqitura në ankim nga subjekti i rivlerësimit Dhurata Bilo, e cila kërkoi: marrjen e provave të reja të paraqitura në ankim; gjykimin e çështjes në seancë publike; vazhdimin e hetimit edhe për dy komponentët e tjerë të procesit të rivlerësimit; ndryshimin e vendimit nr. 370, datë 18.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; si dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Për këtë arsye, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe pikën 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni.
2. Bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 e 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

2.1. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive¹ (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, referuar deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit *vetting*, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar, duke konstatuar se: (a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (b) *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar burimin financiar për krijimin e pasurive*; (c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (ç) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (d) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar², pas procedurës së kontrollit të kriterit të figurës, konstatoi papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

2.3. Këshilli i Lartë Gjyqësor³, pasi kreu procedurën e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, i dërgoi Komisionit raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar, mbi bazën e të cilit nuk u paraqitën problematika për subjektin.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 370, datë 22.04.2021, pasi vlerësoi se kishte prova të mjaftueshme për të marrë vendimin bazuar vetëm në kontrollin e kriterit të pasurisë, Komisioni vendosi të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit, duke konkluduar se: (i) nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurisë në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve, në

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 28.02.2018.

² Dërguar me shkresën e DSIK-së nr. {***} prot., datë 02.12.2017, i deklasifikuar me vendimin e KDZh-së nr. {***}, datë 28.12.2020.

³ Raporti i KLGj-së nr. {***} prot., datë 22.06.2020.

përputhje me shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit të Komisionit, ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit dhe kërkoi: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në Kolegj; (ii) vazhdimin e hetimit administrativ edhe për dy komponentët e tjerë të procesit të rivlerësimit që lidhen me figurën dhe aftësitë profesionale; si dhe (iii) ndryshimin e vendimit të Komisionit, duke e konfirmuar atë në detyrë. Sipas subjektit, vendimi i Komisionit nuk është i bazuar në ligj e në prova, pasi nuk mban në konsideratë parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit. Subjekti pretendon se, bazuar në analizën e paraqitur prej saj në ankim, arrin të provojë bindshëm krijimin e pasurisë me burime të ligjshme dhe arrin një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Përpos pretendimeve që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti paraqiti edhe pretendime të natyrës procedurale dhe të procesit të rregullt ligjor. Në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe shkaqet e ankimit të subjektit paraqiten si në vijim.

4.1. Për pretendimet me natyrë procedurale dhe të procesit të rregullt ligjor, subjekti kërkoi kalimin në seancë dëgjimore publike dhe vazhdimin e hetimit edhe për dy kriteret e tjerë, duke pretenduar se:

- (i) Vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, për shkak se u hetua nga e njëjta trupë gjyqësore që mori vendimin;
- (ii) Gjatë procesit të rivlerësimit është shkelur neni 6, pika 1 e KEDNj-së, për shkak se nuk u gjykua nga një gjykatë e krijuar me ligj -- anëtarët e Komisionit nuk janë gjyqtarë të emëruar sipas rregullave që parashikon ligji për magistratët;
- (iii) Vendimi i marrë nga Komisioni, bazuar vetëm në një kriter, bie ndesh me parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016;
- (iv) Është cenuar e drejta e parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së, pasi shkarkimi nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, meqenëse Komisioni konsideroi si shkak për shkarkimin nga detyra, mungesën e burimeve në vlerën (-) 571.974 lekë. Arsytet e dhëna nga organet e rivlerësimit nuk janë relevante dhe as të mjaftueshme për të justifikuar shkarkimin nga detyra.

4.2. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

(a) Për banesën private dykatëshe, blerë nga subjekti në vitin 2002, e ndodhur në Durrës

Subjekti pretendoi se nuk gjendet në situatën e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Rezultati negativ i analizës financiare të viteve 2003-2008 është pasojë e interpretimit të gabuar të ligjit dhe provave nga Komisioni. Shpërndarja e shpenzimeve të mobilimit ndër vite, duhet të ishte marrë në konsideratë sipas deklarimeve të saj dhe jo sipas një raporti *apriori* të vendosur nga Komisioni. Balanca negative për këtë pasuri në vlerën (-) 571.974 lekë duhet të lexohet në zbatim të parimit të proporcionalitetit.

(b) Për automjetin tip "Mercedes-Benz ML", blerë më datë 29.01.2010

(i) Subjekti pretendoi që nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit me blerësin, pasi koha që kishte kaluar, nga momenti i krijimit të marrëdhënies juridiko-civile deri në procesin gjyqësor, ishte shumë e gjatë;

(ii) Komisioni duhet t'i kishte dhënë vlerë provuese, si akt zyrtar, deklaratës noteriale të hartuar nga blerësi i automjetit tjetër ["Golf TDI"]. Sipas subjektit, nëse pranohet si e ardhur e ligjshme vlera e kaparit prej 7.000 eurosh, të dhënë para blerjes së automjetit, pamjaftueshmëria e burimeve për blerjen e pasurisë objekt kontrolli rezulton në vlerën 1.000 euro, e cila, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk mund të shërbejë si shkak për marrjen e masës së shkarkimit nga detyra;

(iii) Subjekti pretendoi se nuk i janë drejtuar pyetje nga Komisioni dhe as nuk i është kaluar barrë prove për diferencën midis çmimit të blerjes dhe shitjes së automjetit tip "Golf TDI". Në lidhje me moskonsiderimin e fitimit të krijuar nga shitja e automjetit në fjalë si e ardhur e ligjshme, meqenëse nuk janë paguar tatimet, subjekti pretendoi se Komisioni mund ta konsiderojë si të ardhur të paligjshme vetëm diferencën midis vlerës së shitjes me vlerën e blerjes;

(iv) Sipas subjektit, në analizën financiare për mundësinë e krijimit të kësaj pasurie në janar të vitit 2010, duhet përfshirë edhe kreditimi i pagës së muajit dhjetor 2009. Pas kryerjes së analizës, sipas kërkimeve të saj, subjekti pretendon se ka të ardhura të mjaftueshme për krijimin e pasurisë.

*(c) Për apartamentin me sipërfaqe 102 m², ndodhur në {***}, Durrës, blerë në vitin 2013*

(i) Konkluzionet e Komisionit në vlerësimin e kësaj pasurie, sipas subjektit, u bazuan në një interpretim të gabuar të ligjit lidhur me barrën e provës në kuadër të procesit të rivlerësimit. Ajo pretendoi se nuk duhet të ngarkohet barrë prove në rastet e fakteve të prezumuara me ligj. Për shkak se pasuria nuk e kalon nivelin e dyfishit të pasurisë së ligjshme dhe nuk është konstatuar fshehje apo deklaram i rremë, duhet të prezumohet e pafajshme e nuk mund t'i kalojë barrë prove;

(ii) Në analizën e kësaj pasurie, Komisioni nuk mbajti të njëjtin qëndrim për deklarimin e gjendjes *cash* në banesë si në raste të tjera të ngjashme⁴. Në ato raste, Komisioni ka konkluduar se nëse provohet mundësia e krijimit të gjendjeve *cash*, të pretenduara se kanë ekzistuar më parë, por të padeklaruara në deklaratat periodike, mjafton të jetë deklaruar saktësisht në deklaratën *vetting* që subjekti të përjashtohet nga përgjegjësia disiplinore. Edhe në rastin e saj, duke qenë se deklaroi në deklaratën *vetting* se burimi i krijimit të pasurisë janë kursimet ndër vite nga të ardhurat, Komisioni duhej t'i njihte këto kursime si burim të ligjshëm për krijimin e pasurisë në fjalë;

(iii) Subjekti pretendoi se Komisioni nuk mori në konsideratë deklaramet e saj në lidhje me pagesën e këstit të dytë të apartamentit prej 11.600 eurosh, në datën 28.6.2013. Këto të ardhura ishin nga pensioni i nënës së saj dhe duhet të përfshihen në analizën financiare në Kolegj;

⁴ I referohet vendimit të Komisionit nr. 105, datë 12.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Elsa Toska.

(iv) Analiza financiare e viteve 2012 e 2013 duhet rishikuar, sipas pretendimeve në ankim, duke konsideruar se subjekti kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie.

(d) Në lidhje me analizën financiare

(i) Sipas subjektit, sikurse rezulton edhe nga analiza e kryer nga Komisioni, gjendja pasurore për periudhën 1993-2016 është pozitive në vlerën 3.103.893 lekë, çka tregon se të ardhurat e ligjshme mbulojnë plotësisht dhe tejkalojnë detyrimet dhe shpenzimet e kryera për këtë periudhë;

(ii) Analiza e Komisionit ka pasaktësi në shpërndarjen e shpenzimeve të tarifës së doktoratës në vitet 2009-2010. Vlera e këtij shpenzimi prej 416.430 lekësh duhet të konsiderohet nga Kolegji si shpenzim i vitit 2009;

(iii) Ka pasaktësi në përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të cilat nuk përfaqësojnë shpenzimet reale të saj dhe në çdo rast nuk duhet të tejkalojnë nivelin e shpenzimeve jetike të vitit 2013, pasi është person i vetëm;

(iv) Subjekti kërkon që në analizën financiare të kryer nga Komisioni të korrigjohet diferenca në likuiditete, duke zbritur ndikimin e të ardhurave të pensionit të nënës të kredituar në llogari nga viti 2004 deri në vitin 2012. Këto të ardhura kaluan në llogarinë e saj bankare, pasi nëna nuk kishte një llogari bankare të vetën, dhe sollën diferenca negative të pavërteta në rezultatet financiare të këtyre viteve.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit dhe shqyrtohet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankueses

6. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma e shqyrtimit të ankimit në Kolegj

7. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në Kolegj, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Përfundimisht bëjnë rastet kur trupi gjykues gjen se plotësohen kriteret e nenit 51 të

ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, që lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 370, datë 22.04.2021, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi.

7.1. Subjekti ka bashkëlidhur në ankim disa akte të reja, të cilat kërkon të merren në cilësinë e provës në ankim, e konkretisht:

(i) Analizën financiare të periudhave të ndryshme⁵, të cilën kërkon ta marrë në konsideratë Kolegji. Në këtë analizë, paraqiten me bilanc negativ vetëm dy vite, përkatësisht viti 2008 me një vlerë negative prej (-) 4.575 lekësh dhe viti 2013 me një vlerë negative prej (-) 675.445 lekësh; dhe

(ii) Shkresën nr. {***} prot., datë 01.06.2021, të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, që përmban informacion për hyrje-daljet nga dhe për në territorin e Republikës së Shqipërisë, për vëllanë e subjektit [z. A. B.], nga viti 2005 – 31.05.2021.

7.2. Pasi i analizoi këto akte, nën dritën e parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49, datë 02.05.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të mos i pranojë për shqyrtim. *Së pari*, trupi gjykues thekson se këto akte nuk kapërcejnë pragun ligjor të vendosur nga ligj për provat e reja në ankim, në kushtet që subjekti nuk ka argumentuar se cili ka qenë shkaku që i ka krijuar pengesën apo pamundësinë e paraqitjes së provave gjatë hetimit administrativ në Komision, sipas kritereve të nenit 47⁶ të ligjit nr. 49/2012.

7.3. *Së dyti*, përpos dhe duke abstraguuar nga analiza e kritereve për pranimin e provave të reja në ankim, trupi gjykues vëren se nën dritën e parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016⁷, këto akte u vlerësuan të panevojshme e të parëndësishme për vendimarrjen.

(i) Konkretisht, nga një verifikim *en plano* i akteve të dërguara, Kolegji vëren se shkresa e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, nëpërmjet së cilës subjekti synon të provojë se vëllai i saj është gjendur në Shqipëri në momentin kur [ajo pretendon se ai] i ka dhënë vlerën prej 10.000 eurosh – për ndërtimin e shtesës. Meqenëse shtesa nuk u ndërtua, vijon pretendimi, subjekti e përdori vlerën për shlyerjen e pagesës së këstit të dytë të apartamentit që ajo porosi në {***}, Durrës. Nga aktet në fashikull rezulton se ndër shpjegimet dhe provat e paraqitura në seancën dëgjimore në Komision, ndër të tjera, subjekti dorëzoi edhe informacionin rreth hyrje-daljeve të vëllait, gjeneruar nga sistemi *TIMS*. Me fjalë të tjera, ky dokument i është nënshtruar kontrollit nga Komisioni, si dhe debatit në seancën dëgjimore. Në këto kushte, ky akt nuk mund të marrë

⁵ Tabelë financiare përmbledhëse për vitet 1993-2008; tabelë financiare përmbledhëse për vitet 2009-2016; si dhe tabelë financiare përmbledhëse për vitet 1993-2016.

⁶ Neni 47 i këtij ligji përcakton: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkojnë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

⁷ Neni 49, pika 6 e ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[6.] Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) marrja e provës duket se është e panevojshme; (b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjyimit; [...]”.

cilësinë e provës së re në ankim, pasi nuk përbën provë të re, dhe mbi të gjitha nuk paraqet një rrethanë të panjohur për Kolegjin apo që të mund të ndikojë në vendimmarrje.

(ii) Për sa i përket analizës financiare të sjellë rishtazi nga subjekti, trupi gjykues vlerëson se ajo nuk plotëson kriteret e provës së re në ankim. Përpos këtij fakti, në kushtet që analiza financiare e Komisionit i nënshtrohet kontrollit në Kolegji, sipas parimeve të parashikuara nga nenit F i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, vlerat dhe pasqyra financiare në analizën e sjellë me ankimin nuk kanë relevancë, për sa kohë nuk janë përfshirë në analizën e kryer në Komision.

7.4. Në përmbledhje dhe si konkluzion i sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se provat e reja të paraqitura në ankim nuk përmbushin kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nuk u pranuan për shqyrtim nën dritën e dispozitave të nenit 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “d” e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur rrethana që kanë penguar paraqitjen e tyre në Komision, dhe nuk përbëjnë fakte të reja të panjohura më parë, apo të cilat mund të kenë ndikim në vendimmarrjen e Kolegjit.

(d) *Kërkesa për riçelje të hetimit dhe gjykimin në seancë publike*

7.5. Subjekti pretendoi se vendimi i Komisionit, që bazohet në shqyrtimin e vetëm *një kriteri*, është në kundërshtim me Aneksin e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, për një proces rivlerësimi të plotë e të gjithanshëm, në pajtim me të drejtat themelore të saj. Për pasojë, procesi i rivlerësimit është i parregullt edhe në referim të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”) dhe Protokollit nr. 1 të saj. Subjekti argumenton ekzistencën e mungesës së paanshmërisë, për qëllime të nenit 6, pikës 1 të KEDNJ-së sipas: (i) testit subjektiv, ku duhet t’i kushtohet vëmendje nëse gjyqtari ka treguar ndonjë paragjykim apo njëanshmëri personale në një çështje të caktuar; dhe (ii) testit objektiv, apo që ndryshe nga sjellja personale e ndonjë prej anëtarëve, vetëm përbërja e gjykatës ka dhënë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim lidhur me anshmërinë e saj.

7.6. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje se kërkesa e subjektit për vazhdimin e hetimit edhe për dy komponentët e tjerë të procesit të rivlerësimit është e pabazuar, qoftë nën dritën e pikës 1 të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, sikurse edhe nën dritën e parimeve të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga KEDNJ-ja. Ky qëndrim ka gjetur pasqyrim gjerësisht dhe është konsoliduar në vendime të mëparshme të Kolegjit në të cilët është sjellë për shqyrtim çështja e rivlerësimit bazuar mbi një apo disa kriteret⁸. Pa hyrë në përsëritje të jurisprudencës së Kolegjit, çmojmë të theksojmë që kryerja e rivlerësimit mbi një kriter parashikohet shprehimisht nga ligji. Konkretisht, pika 2 e nenit 4 të ligjit nr. 84/2016⁹, parashikon se vendimi i organeve të rivlerësimit merret bazuar në një ose disa prej kriterëve të rivlerësimit. Kjo dispozitë passjell që në rastet e një rezultati negativ/jokalues në njërin prej kriterëve, edhe në situatën që dy kriteret e tjera do të rezultojnë pozitivisht për subjektin, vendimmarrja nuk do të ishte pozitive në kushtet që konfirmimi në detyrë kushtëzohet nga vlerësimi pozitiv i të tri kriterëve. Me fjalë të tjera, nën dritën e këtyre parashikimeve ligjore, organet e rivlerësimit mund të marrin vendimin bazuar

⁸ Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit (JR) nr. 3/2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Fatos Lulo, paragrafi 17 dhe (JR) nr. 9/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, paragrafi 15.8.

⁹ “[2.] Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

vetëm në njërin kriter, pa cenuar ndonjë prej të drejtave të subjekteve, qoftë parë si derivat i të drejtave procedurale apo konstatimit të drejtë të situatës faktike – dy kriteret e parashikuara nga pika 1 e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 – në kushtet që vlerësimi pozitiv duhet të rezultojë nga të tri kriteret për të passjellë konfirmim në detyrë.

7.7. Nga kontrolli i vendimit rezulton se Komisioni ka hetuar për të tri kriteret dhe përfundimisht vijoi procesin për kriterin e pasurisë. Po ashtu, nga aktet rezulton se qoftë subjekti apo edhe anëtarët e trupit gjykues të Komisionit janë shprehur se nuk gjenden në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti u njoh me provat dhe rezultatet e hetimit administrativ, iu përgjigj pyetësorëve, si dhe paraqiti shpjegimet në përmbushje të barrës së provës. Në përmbushje të barrës së provës, subjekti kërkoi vijimin e hetimit edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit. Komisioni arsyetoi se provat e administruara deri në atë fazë, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kishin arritur nivelin e provueshmërisë dhe *ishin të mjaftueshme* për përfundimin e procesit administrativ bazuar *vetëm mbi këtë kriter*, në përputhje me pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016¹⁰. Në përfundim, Komisioni konkludoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm, shoqëruar me mungesë burimesh të ligjshme, me pasojë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, situatë e parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

7.8. Trupi gjykues i Kolegjit vëren më tej se pretendimi i subjektit se është cenuar Protokoli 1 i Konventës në rastin e saj është i pakuptimtë. Protokoli 1 parashikon një sërë të drejtash që mbron KEDNJ-ja, duke përfshirë të drejtën e pronës, të drejtën për arsim dhe të drejtën për zgjedhje të lira. Nga analiza e procedurës dhe e vendimit të Komisionit, si dhe pretendimeve në ankim, nuk rezulton të jetë cenuar ndonjë prej këtyre të drejtave për shkak të masës disiplinore të marrë nga Komisioni. Vendimi i shkarkimit nga detyra është marrë në zbatim të përcaktimit të shprehur nga ligji në situatat e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për deklaram të pasaktë për pasurinë, që nuk mund të argumentohet se cenon të drejtat e mbrojtura nga Protokoli 1. Po ashtu, edhe subjekti nuk rezulton të ketë ilustruar në çfarë mënyre, sesi masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, cenon ndonjë prej të drejtave të mbrojtura nga Konventa. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen këtë pretendim të pabazuar.

7.9. Në përmbledhje të sa më sipër, nga kontrolli i procedurës së ndjekur nga Komisioni, si dhe nga verifikimi i analizës së kryer për aktet e marra në shqyrtim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se nuk është i nevojshëm debati gjyqësor me praninë e subjektit, pasi gjendja faktike rezulton të jetë konstatuar në mënyrë plotë dhe nuk ka nevojë të merren aktet e reja, sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Vendimi nuk rezulton të jetë marrë si pasojë shkeljesh procedurale dhe nga aktet e parashtrimet nuk konstatohet nevojë e përsëritjes së marrjes së disa apo të të gjithë provave.

7.10. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se hetimi administrativ dhe më pas vendimi i Komisionit janë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe subjektit i janë respektuar të drejtat procedurale, qoftë në procesin e kryer, ashtu edhe nëpërmjet vendimit të bazuar në një kriter. Në referim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, shtjelluar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, pretendimi i subjektit se duke u shkarkuar bazuar vetëm në njërin kriter, vendimi i Komisionit përbën shkelje të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

¹⁰ Shih paragrafin 11 të vendimit objekt shqyrtimi: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim-Dhurata-Bilo.pdf>

është i pambështetur në ligj e prova. Pretendimet e tjera që lidhen me aspektet e procesit të rregullt ligjor gjejnë trajtim në këtë vendim në vijim.

7.11. Në përfundim të këtij arsytimi, Kolegji çmon se aktet e sjella me ankimin duhet të refuzohen në zbatim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk lejohen nga ligji të merren në shqyrtim – arsyetuar më sipër nën dritën e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 – si dhe për shkak se janë të panevojshme për vendimmarrjen dhe lidhen me fakte që, edhe nëse pranohen të mirëqena, janë pa rëndësi në zgjidhjen e çështjes apo nuk do të ndryshonin rezultatin përfundimtar, parashikuar nga shkronjat “b” dhe “d” të pikës 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për gjykimin e çështjes në seancë publike dhe e shqyrtoi çështjen mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, sipas nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për procesin e rregullt ligjor

(i) Gjykimi i çështjes nga një gjykatë e krijuar me ligj

8. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit se *është shkelur neni 6, pika 1 e KEDNj-së, pasi nuk u gjykua nga një gjykatë e krijuar me ligj*, meqenëse anëtarët e Komisionit nuk janë gjyqtarë të emëruar sipas rregullave që parashikon ligji për magjistratët.

8.1. Vlerësimi i këtij pretendimi u krye nën dritën e opinionit të Komisionit të Venecias, vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe të çështjes *kyç* të gjykuar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, përpos edhe sa është elaboruar nga jurisprudenca e Kolegjit në mënyrë shteruese. Në vijim të jurisprudencës së Kolegjit, e mbështetur edhe në standardet e elaboruara nga GjEDNj-ja në çështjet *Ástráðsson kundër Islandës*¹¹ dhe *Cani kundër Shqipërisë*, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i pabazuar pretendimi se është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj, për shkak se komisionerët nuk janë gjyqtarë të emëruar, sipas rregullave që parashikon ligji për magjistratët. Nën dritën e gjithë sa renditur më sipër dhe duke abstrguar nga fakti që për herë të parë ky kërkim është ngritur vetëm në ankim, në linjë me arsyetimin e shtjelluar e konsoliduar në vendime të mëparshme për këtë aspekt¹², trupi gjykues rithekson faktin që përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit iu nënshtua disa procedurave të mirëpërcaktuara në Kushtetutë [neni C i Aneksit të saj dhe neni 6 i ligjit nr. 84/2016], të konfirmuara edhe nga GjEDNj-ja në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* dhe kishte për qëllim të materializonte në praktikë vullnetin politik të kushtetutëbërësit nëpërmjet një procesi të kufizuar në kohë, për të kthyer besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

8.2. Po ashtu, në të njëjtën linjë me burimet e mësipërme të jurisprudencës, edhe pretendimi i subjektit se vendimi i Komisionit është rezultat i një *procesi të paragjykuar*, meqenëse hetimi u krye nga i njëjti trup gjykues që mori vendimin në Komisioni, nuk qëndron. Fakti që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe mënyra sesi ai merr vendime kanë kaluar disa filtra të

¹¹ *Vendimi i GjEDNj-së në çështjen Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës:*
<https://hudoc.echr.coe.int/?i=001-206582>

¹² *Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit (JR) nr. 43/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Hajrie Muçmata dhe (JR) nr. 3/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj.*

përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, përfshirë nenin 6 të KEDNj-së, sikurse rezulton nga opinioni i Komisionit të Venecias nr. 868/2016 [CDL-AD(2016)036]¹³ apo arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, si dhe i GjEDNj-së në çështjen kyç *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, i cili ka marrë formë të prerë përpara se subjekti të depozitonte ankimin objekt shqyrtimi¹⁴, e bën të panevojshëm vijimin e arsyetimit të këtij pretendimi nga trupi gjykues i Kolegjit. GjEDNj-ja ka vlerësuar se procesi i kryer në Komision nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së. Po aty, GjEDNj-ja konkludoi se hetimi, gjykimi dhe marrja e vendimit nga e njëjta trupë gjykuese nuk përbënte cenim të parimit të procesit të rregullt ligjor¹⁵.

8.3. Përpos sa më sipër, parë në kontekstin konkret, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë shembull për të ilustruar veprime/vendime të marra nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, si pasojë e të cilëve ajo ka krijuar perceptimin e paragjykitimit në vendimin e marrë për të. Po ashtu, nuk janë identifikuar me shembuj as pretendimet për mungesë paanshmërie të komisionerëve, të cilat paraqiten në nivel të përgjithshëm. Në këto kushte, dhe duke mbajtur në konsideratë që nga analiza e kryer në Kolegji procedura e ndjekur nga Komisioni rezultoi në përputhje me rregulloren e “Hapave proceduralë të unifikuar”¹⁶, pretendimi i subjektit se vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar nuk qëndron. Përkundrazi, nga analiza e kryer për kontrollin e vendimit në Kolegji, rezulton që Komisioni ka favorizuar në më shumë se një rast dhe me shpjegime të paqarta subjektin duke i pranuar pretendime tërësisht deklarative e që bien ndesh me aktet e kohës¹⁷, sikurse do të elaborohet në vijim.

8.4. Në përmbledhje të gjithë sa më sipër, trupi gjykues vëren që pretendimet me bazë të drejtat për proces të rregullt, parashtruar nga subjekti i rivlerësimit, janë përpos të pa-arsyetuara me rrethana konkrete, edhe të pabazuara në ligj. Procesi i hetimit administrativ të kryer nga Komisioni është në respektim të garancive procedurale të njohura nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016.

(ii) *Parimi i proporcionalitetit në kuptim të nenit 8 të KEDNj-së*

8.5. Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që edhe ky pretendim është i pabazuar. Komisioni ka pasqyruar në konkluzionin përfundimtar versionin më të mirë të mundshëm të analizës financiare për të paktën njërën nga pasuritë, pasi ka zgjedhur të pranojë

¹³ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

¹⁴ Vendimi i GjEDNj-së në *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* ka marrë formë të prerë më 31.05.2021, ndërsa ankimi i subjektit është depozituar më 08.06.2021.

¹⁵ [...] 308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së.

¹⁶ <https://kpk.al/hapat-procedurale-te-unifikuar-per-rivleresimin-e-subjekteve-nga-trupat-gjykuese-te-komisionit-te-pavarur-te-kualifikimit/46/>

¹⁷ Ndër të tjera, Komisioni ka pranuar pretendime deklarative të subjektit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, ndonëse ato binin ndesh me aktet e kohës për koston e shtesës së shtëpisë së subjektit, nga të cilat rezultonte një vlerë disafish më e lartë shpenzimesh të dakordësuara me kontratën e sipërmarrjes, e deklaratën periodike vjetore, që përbënin akte të kohës.

shumë pretendime të subjektit të parashtruara *vetëm* në një fazë të avancuar të procesit [pasi ajo u njoh me rezultatet e hetimit]. Po ashtu, pavarësisht se Komisioni ka konstatuar edhe problematika të tjera për të cilat nuk e ka penalizuar subjektin¹⁸ apo, sikurse referuar më sipër, ka pranuar edhe pretendimet e saj që bien ndesh me akte të kohës, subjekti ka rezultuar gjithsesi në kushtet e deklaramit të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe mungesës së burimeve të ligjshme në vlerën totale (-) 4.070.996 lekë, për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve e investimeve. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se arsyet për marrjen e masës disiplinore nuk janë proporcionale është alogjik përveçse i pabazuar.

8.6. Komisioni e mbështeti vendimmarrjen në elementet si: (i) mosshpjegimi bindshëm i burimeve të ligjshme të pasurive, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; (iii) deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e shtëpisë dykatëshe të banimit. Në këtë rast, në mbështetje edhe të praktikës së Kolegjit¹⁹, nuk ka vend për analizë nëse masa disiplinore e shkarkimit është disproporcionale, pasi balanca negative edhe pas qasjes favorizuese ka rezultuar e konsiderueshme. Për rrjedhojë, trupi gjykues vëren se balanca negative, së bashku me problematikat e tjera të konstatuara nga Komisioni, janë elemente të mjaftueshme për të mbështetur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, lidhur në rastin konkret me shkronjën “b”²⁰ të pikës 5 të nenit 33 të të njëjtit ligj. Për pasojë, edhe ky pretendim i subjektit u gjet i pambështetur në ligj e në prova.

8.7. Nga kontrolli i vendimit dhe i procedurës së ndjekur nga Komisioni nën dritën e përcaktimeve të nenit 8 të KEDNJ-së²¹, trupi gjykues konstaton se hetimi administrativ i kryer për subjektin nuk paraqet në asnjë element ndërhyrje në jetën private apo atë familjare të subjektit. Edhe nën dritën e arsyetimit të GjEDNJ-së në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, sikurse referuar më sipër, masa disiplinore e shkarkimit apo edhe hetimi administrativ i kryer nuk mund të argumentohet si një ndërhyrje e pajustificuar në të drejtën për jetë private apo në jetën profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në linjë me sa është shtjelluar gjerësisht edhe në vendime të mëparshme të Kolegjit²², në referencë të jurisprudencës së GjEDNJ-së për kufijtë e ndërhyrjes dhe garancitë e nenit 8 të Konventës, ndalimi për të ushtruar detyra të caktuara brenda sistemit të drejtësisë, që passjell procesi i rivlerësimit për subjektin nuk është disproporcional

¹⁸ Referuar analizës së Komisionit për çështjen e konfliktit të interesit nën analizën e krijimit të automjetit të blerë në vitin 2010.

¹⁹ Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit (JR) nr. 1/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Andi Civici, paragrafi 17.4. dhe vendimin e Kolegjit (JR) nr. 9/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, paragrafi 15.9.

²⁰ “[...] (b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; [...]”.

²¹ “(1) Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. (2) Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.

²² Shih § 314 të vendimit në *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, lidhur me referencën në Naidin kundër Rumanisë, 21 tetor 2014, § 54-55, për ndalimin e natyrës absolute për një ish-bashkëpunëtor të policisë politike për t’u punësuar në administratën publike, përkundër Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë § 58, Rainys dhe Gasparavičius kundër Lituanisë § 36, 7 prill 2005; dhe Žičkus kundër Lituanisë § 31, lidhur me ndalesën e mundësive të një individi për t’u punësuar në sektorin privat.

dhe as në mospërputhje me objektivin legjitim të shtetit për të siguruar integritetin e gjyqësorit dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

8.8. *Së fundmi*, nuk rezulton që Komisioni të ketë ngarkuar subjektin e rivlerësimit me një barrë disproporcionale gjatë hetimit administrativ. Ndërsa çështja e rivlerësimit për subjektin është shortuar në datën 12.11.2019, rezultatet e hetimit administrativ, për të cilat ajo është ftuar të japë shpjegime, i janë përcjellë më 15.02.2021, që nënkupton 15 muaj më pas. Subjekti ka ndërvepruar me Komisionin dhe i është përgjigjur disa pyetësorëve. Vendimi për të zhvilluar seancën dëgjimore të datës 19.04.2021, i është njoftuar asaj në një kohë më se të mjaftueshme, mbi një muaj më herët, më 17.03.2021. Nga ana tjetër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës dhe referuar dokumentacionit mbi të cilin janë arritur vlerësimet paraprake pas një hetimi që ka zgjatur në total 19 muaj.

8.9. Subjekti ka dhënë shpjegime e sjellë aktet që ka zgjedhur për të mbështetur pretendimet e saj, dhe në asnjë çast nuk ka ngritur ndonjë pretendim të natyrës së cenimit të jetës private apo të ngarkesës me barrë disproporcionale. Nën dritën e këtyre fakteve, që rezultojnë qartë nga aktet në fashikull, është e pamundur të argumentohet një barrë disproporcionale qoftë në nivel parimor, për shkak të procesit të rivlerësimit në vetvete apo edhe duke analizuar rrethanat konkrete të hetimit administrativ të kryer për subjektin, në drejtim të mundësisë së dhënë asaj për të sjellë prapësime e prova. Subjekti ka pasur kohë të mjaftueshme për të dhënë përgjigje e kundërshtuar rezultatet e hetimit administrativ apo për të sjellë akte në mbështetje të pretendimeve. Asaj i është dhënë mundësia edhe në seancën dëgjimore për të parashtruar qëndrimin e saj dhe kundërshtuar konstatimet paraprake të Komisionit, i cili, ndër të tjera, ka pranuar një sërë aktesh shkresore të sjella prej saj.

8.10. Në përmbledhje të sa më lart, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit është marrë në zbatim të parimeve procedurale të parashikuara nga ligji nr. 84/2016, Kushtetuta dhe Aneksi i saj, si dhe Kodi i Procedurave Administrative. Subjektit i janë respektuar të drejtat për proces të rregullt ligjor. Pretendimi për të zbatuar parimin e proporcionalitetit rezulton i pakuptimtë e i pabazuar. Ky vlerësim mban në konsideratë që, ndonëse Komisioni ka pranuar të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pasurinë e parë, përfshirë edhe ato të paraqitura për herë të parë gjatë një faze të avancuar të hetimit administrativ e në kundërshtim me deklaratimet e saj të mëhershme, situata financiare gjithsesi mbetet me balancë negative të burimeve të ligjshme në vlerën (-) 4.070.996 lekë.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e kontrollit të pasurisë

9. Sikurse referuar më sipër, fillimisht Komisioni ka konstatuar një balancë negative prej (-) 7.658.204 lekësh për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve nga subjekti. Në vendimin përfundimtar, pasi ka marrë në konsideratë një sërë shpjegimesh të saj, Komisioni ka pasqyruar një tabelë²³, sipas së cilës shumatorja e viteve me mungesa rezulton të jetë në vlerën prej (-) 4.370.996 lekësh. Kjo balancë negative është rezultat i mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e dy pasurive të paluajtshme, një automjeti dhe mbulimit të shpenzimeve të

²³ Shih faqen 23 të vendimit të Komisionit, me tabelën përmbledhëse, nga e cila rezultojnë me balancë negative tetë (8) vite. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim-Dhurata-Bilo.pdf>.

deklaruara. Subjekti ka ngritur shkaqe ankimi për secilin prej këtyre aspekteve, duke pretenduar se edhe analiza përfundimtare e Komisionit është e pabazuar.

9.1. Nga vlerësimi i akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konfirmohet minimalisht një balancë negative në vlerën e pasqyruar edhe në vendimin e Komisionit. Edhe në vlerësimin e kryer në Kolegj, mungesa e burimeve të ligjshme për aspektet e vlerësimit të pasurisë, për të cilat Komisioni ka konstatuar problematika, qëndron. Ky konkluzion mban në konsideratë problemet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e dy pasurive të paluajtshme, shtëpi në zonën historike të qytetit të Durrësit, apartament në plazh [në Durrës], sikurse edhe një automjet, si dhe analizën financiare në funksion të përballimit të shpenzimeve e të krijimit të pasurive. Në vijim, arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion, së bashku me pretendimet e subjektit për secilin aspekt.

C.1. Banesë trekatëshe me sipërfaqe ndërtimi 71,64 m², në rrugën “{***}”, Durrës

10. Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin [në vijim, deklarata vetting], subjekti ka deklaruar pasurinë objekt analize, në vlerën 3.4 milionë lekë, blerë në datën 22.10.2002. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë: “Blerë dhe pjesërisht përfituar nga ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”. Në deklaratën e parë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar të njëjtën vlerë për pasurinë 34 milionë lekë²⁴ dhe burim nga kursimet dhe kredia²⁵. Nga kontrata e shitjes, rezulton se banesa është blerë kundrejt çmimit 2 milionë lekë dhe ka një sipërfaqe²⁶ trualli 154,14 m² dhe ndërtimi 71,64 m².

10.1. Nga aktet në fashikull rezulton sa vijon:

a. Në kontratën e shitjes, shitësja [znj. F. B.] dhe subjekti kanë specifikuar se pagesa është kryer e gjitha në prani të noterit.

b. Gjatë hetimit administrativ në Komision²⁷, subjekti depozitoi edhe një kontratë huaje të lidhur me shitësen e apartamentit, që mban të njëjtat elemente identifikuese, si edhe kontrata e shitjes, përfshirë edhe të njëjtën datë, por në një distancë kohore prej 30 minutash. Nëpërmjet saj, shitësja deklarohej t’i ketë dhënë hua subjektit 1.4 milionë lekë pa qëllim përfitimi, deri më 01.11.2003. Shuma i është dhënë subjektit jashtë zyrës noteriale. Vlen të theksohet se si kontrata e shitjes, edhe deklarata e re e huas, ndonëse parashikojnë veprime të ndryshme juridike, mbajnë të njëjtin numër repertori [nr. {***}] e koleksioni [nr. {***}], me ndryshimin që shënohet se janë hartuar në një hark kohor prej 30 minutash nga njëra-tjetra, pranë të njëjtit noter. Huaja deklarohej e dhënë pas shitjes së shtëpisë. Më datë 12.10.2003, palët kanë hartuar një deklaratë noteriale²⁸ me të cilën shprehen për shlyerjen e gjithë detyrimit brenda afatit (më 01.11.2003).

²⁴ Subjekti këtu duket se i referohet mënyrës së hershme të shprehjes së lekut dhe nuk e ka evidentuar në “lekë të reja” apo “të vjetra”. Marrë në përputhje me aktet në dosje dhe me deklaratën vetting, subjekti i është referuar në “lekë të vjetra”.

²⁵ Komisioni duket se ka interpretuar mënyrën e shprehjes së subjektit në referimin e konceptit “kredi”, duke e prezumuar se flitet për çekun e lëvruar nga EKB-ja -- për të si e pastrehë – me vlerë afërsisht 1.5 milion lekë, në kushtet që subjekti nuk ka specifikuar një kredi të përfituar. Shih pikën 2.2. dhe pikën 2.6/i të vendimit të Komisionit.

²⁶ Në vërtetimin hipotekor pasuria referohet me sipërfaqe 400 kut.

²⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, në datën 26.12.2020.

²⁸ Nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol.

c. Në datën 15.04.2003, subjekti ka lidhur një kontratë noteriale sipërmarrjeje dhe investimi [nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol.], përpara të njëjtit noter si edhe më sipër. Nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e investitores/porositëses, ka rënë dakord me një person fizik të licencuar në ndërtim [z. SH. K.] si sipërmarrës të kryejë një rikonstruksion të *plotë* për ndërtesën në fjalë, sipas projektit të miratuar nga KRRT-ja Durrës për tre kate banesë²⁹, nga të cilët dy kate në sipërfaqe 80 m² secili dhe papafingo 25 m². Afati i përfundimit do të ishte data 15.07.2003. Sipas këtij akti, subjekti i ka paguar sipërmarrësit në datën e lidhjes së kontratës vlerën prej 3.884.700 lekësh *tërësisht*, në *cash*, jashtë zyrës noteriale për rikonstruksionin e *plotë*. Palët po ashtu janë shprehur se pagesa përbën vlerën e *plotë* të shlyer të rikonstruksionit të rënë dakord, që përbën *ekzekutim të plotë të detyrimit financiar* nga sipërmarrësja porositëse për ndërtesën në fjalë përpara noterit. Palët janë shprehur që kjo marrëveshje mund të zgjidhet me pëlqimin e të dy palëve, *vetëm me akt noterial*. E njëjta vlerë shpenzimesh konfirmohet edhe nga preventivi i detajuar në zëra, hartuar nga ndërtuesi i licencuar [ing. SH. K.], sipas së cilit vlera totale e preventivuar me TVSH arrin në 4.861.000 lekë.

d. Në datën 21.03.2003, subjekti ka përfituar nga Banka e Kursimeve vlerën *neto* prej 1.511.330 lekësh me çek, në funksion të vendimit të EKB-së që e ka lëvruar pagesën e saj si e pastrehë³⁰.

e. Subjekti ka përfituar kredi për shtëpi³¹, nga Banka Kombëtare e Greqisë (NBG) përkatësisht 15.000 USD më 25.03.2003 dhe 10.000 USD më 10.11.2004. Të dy kreditë janë marrë për *ndërtim banese* në qytetin e Durrësit, dhe referuar adresës, janë për shtëpinë objekt analize.

f. Në deklaratën e parë të vitit 2003, subjekti e deklaroi kredinë në vlerë 15.000 USD dhe qëllimin e saj *për rikonstruksionin e banesës dy kate*, ndërsa në deklaratën periodike për vitin 2004, subjekti e deklaroi kredinë, por jo qëllimin. Sidoqoftë, nisur nga qëllimi për të cilën subjekti e mori kredinë, shoqëruar edhe me deklarin e parë në vitin 2003, logjikisht dhe sipas këtyre referimeve të kohës, rikonstruksioni konsiderohet se përbëhet nga vlerat e kredive të marra për këtë qëllim, që në total arrijnë në vlerën 25.000 USD.

g. Sipas një kontratë qiraje të datës 31.03.2010, subjekti ka marrë me qira një truall me sipërfaqe 180 m², në pronësi të Komunitetit Mysliman Shqiptar, Myftinia Durrës, për një periudhë dyvjeçare, me pagesë 8.500 lekë në muaj. Në këtë kontratë specifikohet se të gjitha shpenzimet e kryera nga qiramarrësja për gjelbërimin apo rrethimin me kangjella të kësaj sipërfaqeje do të zbriten nga qiraja.

h. Në vitin 2013, Myftinia Durrës ka nisur një proces gjyqësor ndaj subjektit, duke kërkuar zgjidhjen e kontratës së qirasë, dorëzimin e truallit, si dhe pagesën e qirasë së papaguar. Paditësit kanë pretenduar se subjekti ka vijuar të posedojë në keqbesim pronën e marrë me qira përtej

²⁹ Sipas kontratës, në katin e parë dhe të dytë do të ndërtoheshin dy dhoma me ndarjet përkatëse të ambienteve, me sipërfaqe 80 m² secili dhe nënçatia do të bëhej papafingo, me nëndarjet përkatëse mes ambienteve, me sipërfaqe totale prej 25 m².

³⁰ Nga aktet në fashikull rezulton një deklaratë noteriale e subjekti që mban datën 03.04.2003, sipas së cilës mbështetur në relacionin e Drejtorisë Qendrore, VKM-në nr. 153/2001 "Për procedurat e operimeve financiare" dhe ligjit nr. 8030/1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", ajo ka përfituar si e pastrehë, një tarifë në vlerën 1.840.820 lekë". Sipas tarifave të kohës, vlerësimi i detyrimit ndaj shtetit për znj. Dhurata Bilo është përlllogaritur në vlerën 329.490 lekë.

³¹ Të dy kreditë të konvertuara në lekë arrinin në vlerën 2.938.200 lekë.

afateve të kontratës dhe ka nisur disa punime e gërmime në këtë truall. Në procesin në fjalë, është regjistruar edhe një kundërpadi nga subjekti, cila ka kërkuar zgjidhjen e kontratës së qirasë, njohjen e pronësisë mbi sipërfaqen 142 m², si dhe kthimin e pagesave të qirasë të përfituara nga Myftinia Durrës, me pretendimin se ka një mbivendosje në hartën treguese të hipotekës e për shkak të një konvertimi të gabuar të sipërfaqes nga njësia *kut* në *metër katror* [m²]. Në dokumentacionin e dosjes gjyqësore, gjendet edhe një preventiv [hartuar nga ing. L. SH.], në mars 2010, me investitorë subjekti dhe Myftinia Durrës, sipas së cilit punimet për murin rrethues të truallit në fjalë, kushtojnë 200.000 lekë. Në akte gjendet edhe një situacion, sipas së cilit subjekti ka shlyer pagesën më 31.03.2010.

10.2. Detyrimet dhe përcaktimet ligjore që rezultojnë të ketë marrë përsipër subjekti, sipas akteve të referuara më lart, paraqesin rëndësi në arsyetimin e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit në kushtet që gjatë procesit, subjekti ka parashtuar një version faktesh e vlerë detyrimesh financiare të ndryshme. Subjekti ka kundërshtuar mënyrën e pagesës së shtëpisë shitëses së saj, vlerën e shpenzuar për rikonstruksionin dhe përgjithësisht gjithë panoramën e veprimeve financiare dhe kohën e shlyerjes së detyrimeve që rezulton nga sa më sipër. Sipas pretendimeve të subjektit: (i) ka paguar vetëm 600.000 lekë në momentin që ka blerë shtëpinë, ndërsa shitësja në mirëbesim³² ka pranuar të përfitojë 1.400.000 lekë, pasi subjekti ka marrë kontributin financiar nga shteti si e pastrehë; (ii) ka shpenzuar në total 3.4 milionë lekë për shtëpinë, vlerë në të cilën rikonstruksioni ka qenë vetëm 1.4 milionë lekë; (iii) rikonstruksioni ka nisur me marrjen e kredisë bankare në vitin 2003 dhe është kryer nga *njerëzit e saj ustallarë*; (iv) nuk ka kryer ndërtim të ri, vetëm përshtatje të ambientit të blerë; si dhe (v) rikonstruksionin dhe punimet në vlerën 3.9 milionë lekë, sipas kontratës së sipërmarrjes së vitin 2003 [referuar në paragrafin 10.3/c më sipër], e ka dakordësuar në fakt shitësja, e cila më pas është tërhequr. Në mbështetje të këtij versioni të ndryshëm, subjekti ka sjellë akte të prodhuara *gjatë procesit*³³.

10.3. Pranimi nga Komisioni i këtyre pretendimeve të reja dhe akteve të hartuara rishtazi, që bien ndesh me aktet e kohës, ka passjellë zbutjen e balancës negative fillestare prej (-) 2.101.124 lekësh e të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie për periudhën 2003-2008 në (-) 571.974 lekë, por gjithsesi nuk ka arritur të përmbysë në pikën fundore rezultatin përfundimtar. Në vendimin e Komisionit nuk ka arsyetim për të shpjeguar përse nga dy grupet e dokumenteve i është dhënë peshë vendimtare atyre të hartuara gjatë rivlerësimit, pavarësisht përcaktimeve nën

³² Në deklaratën e saj noteriale të sipëreferuar, shitësja [znj. B./K.] shprehet, ndër të tjera, se ajo vetë [shitësja] ka “insistuar” të shënojë në kontratën e shitjes që ka marrë gjithë vlerën e plotë ndonëse ka marrë vetëm 600.000 lekë nga 2.000.000, meqenëse blerësja “i është dukur vajzë e mrekullueshme” dhe ia ka kërkuar si favor subjektit të respektonte kontratën e sipërmarrjes të cilën vetë ndërtuesi e kishte përgatitur “ndërkohë që ai i kishte bërë gati të gjitha, madje edhe kontratën e kishte bërë sikur e kishte marrë pagesën paraprakisht, vetëm që të niste projektin.”

³³ Deklaratë noteriale nga F. B. [F. K.] datë 24.02.2021, e cila deklaron në një linjë me subjektin për kontratën e sipërmarrjes së vitit 2003, për rikonstruksionin e shtëpisë që kishte shitur në vitin 2002, deklaratë noteriale të djalit të sipërmarrësit [z. E. K.], i cili, në linjë me subjektin e rivlerësimit, deklaron se shpenzimet e marra përsipër e deklaruar nga i ati i ndjerë, të përfituara si “ekzekutim i plotë i detyrimit”, në fakt nuk janë përfituar dhe ishin pasojë e marrëveshjes me shitësen dhe jo me subjektin e rivlerësimit. Subjekti ka sjellë edhe një preventiv punimesh rikonstruksioni në vlerën 1.393.000 lekë, ku shënohet mars 2004 dhe situacion punimesh ku shënohet si kohë qershor 2003.

dritën e kriterëve që duhet të përmbushin aktet për të qenë provë e besueshme, sipas përcaktimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016³⁴ apo të fuqisë ligjore që kanë kontratat sipas Kodit Civil³⁵.

10.4. Konkretisht, ndryshe nga sa referohet në mënyrë të shprehur nga palët në kontratën e shitjes, në pyetësonin nr. 2, datë 10.05.2020, subjekti ka deklaruar dhe Komisioni ka pranuar që shlyerja e çmimit të shitjes është bërë në pjesë: 600.000 lekë në momentin e nënshkrimit të kontratës [më 22.10.2002] dhe 1.4 milion lekë në datën 12.10.2003, pasi subjekti përfitoi çekun nga EKB-ja. Për sa i përket ndryshimit të këtyre vlerave nga 3.4 milionë lekë, të deklaruar prej saj në deklaratën *vetting*, subjekti ka pretenduar se vlera 1.4 milion lekë pasqyron koston e rikonstruksionit të banesës. Shuma 600.000 lekë në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes [në datën 22.10.2002], sipas versionit të paraqitur për pagesat gjatë hetimit administrativ, është pranuar nga Komisioni të jetë krijuar nga subjekti me kursime të viteve 1993 – 2002, e thënë ndryshe, përpara se subjekti të kishte detyrimin për deklarimin periodik vjetor sipas ligjit nr. 9049/2003, të cilat mund të përdoren si provë në procesin e rivlerësimit.

10.5. Në vijim të kësaj analize dhe të kontradiktave të theksuara në shpjegimet e subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimeve të saj për mënyrë pagese të shtrirë në kohë u mungon besueshmëria, sikurse edhe pretendimeve gjatë hetimit për arsyet e marrjes së huas apo blerjes së ngutshme. Subjekti ishte bashkëpronare me familjen në një banesë ku edhe jetonte dhe ishte miratuar për të përfituar nga shteti si e pastrehë me vendimin e Këshillit Bashkiak që daton në nëntor 2001 dhe përfitimi financiar/subvencioni ishte miratuar më 21.03. 2002 me vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës.

10.6. Së dyti, subjekti ka qenë kontradiktore në vijimësi për burimin e krijimit të kësaj pasurie [sikurse edhe për vlerën e investimeve të kryera për të, që shtjellohet në detaj në vijim]. Konkretisht, ndërsa në deklaratën e parë, plotësuar në mars 2004, subjekti ka specifikuar si burim *kursime* dhe *kredi*, i vetmi burim i shprehur në mënyrë direkte në deklaratën *vetting* është përfitimi nga *ligji nr. 8030/1995* – që nënkupton subvencionin nga shteti lëvruar nëpërmjet EKB-së në vlerën 1.5 milion lekë (afërsisht), si e pastrehë. Në asnjë nga këto dy dokumente, për të plotësimin e saktë të të cilëve ajo mban përgjegjësi ligjore, nuk kanë gjetur pasqyrim huaja nga shitësja e shtëpisë apo të ardhurat e krijuara nga përfitimi financiar, akorduar nga EKB-ja. Kontrata e huas, paraqitur me përgjigjet e pyetësonit nr. 4³⁶, referuar më sipër në paragrafin 9.3/b, sipas së cilës në momentin e blerjes subjekti ka paguar vetëm 600.000 lekë, ndërsa huaja prej 1.4 milion lekësh, marrë nga shitësja si pjesë e vlerës totale të çmimit të shtëpisë (2.000.000 lekë – 1.400.000 lekë), rezulton të jetë një akt i kohës, pavarësisht disa aspekteve të paqarta të numrave identifikues të sjellë në vëmendje më sipër.

10.7. Ajo që vlen të theksohet në këtë kontekst është që subjekti pretendon se e ka shlyer huan pasi EKB-ja ka lëvruar pagesën në favor të saj, si e pastrehë. Po ashtu, nga aktet rezulton se ndërsa pagesa e prej rreth 1.5 milion lekësh nga EKB-ja i është kredituar në datën 21.03.2003,

³⁴ “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelit i bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”.

³⁵ Neni 690 i Kodit Civil: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”.

³⁶ Ky akt është depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësonit nr. 4, ndërkohë deklarata e shlyerjes së huas, që referon ekstremitetet e kësaj kontrate, gjendet edhe në dosjen e ILDKPKI-së.

subjekti ka deklaruar shlyerjen e huas shitëses së shtëpisë më 12.10.2003, rreth shtatë (7) muaj pasi në fakt ka ndodhur. Ky fakt shton elementë të tjerë kontradiktorë në mjegullnajën e deklarimit të burimeve financiare që ka disponuar subjekti dhe përdorimin e tyre në funksion të krijimit të kësaj pasurie, në kushtet që subjekti ka përfituar edhe dy kredi të tjera në periudhën kohore 2003 dhe 2004, nga NBG-ja, referuar më sipër në paragrafin 10.3/e. Nëpërmjet kësaj mënyre deklarimi, duket sikur subjekti ka dashur të dokumentojë huan, por jo vlerën e plotë të pronës – 3.4 milionë lekë -- në momentin e blerjes.

10.8. Komisioni duket se i ka kushtuar vëmendje pyetjes nëse subjekti ka kryer rikonstruksion të banesës apo ndërtim të ri. Në të njëjtën linjë, pasi ka pranuar pretendimet e subjektit gjatë pyetësorëve e pas rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni nuk përfshiu në analizë shpenzimet e rikonstruksionit sipas kontratës së sipërmarrjes, ndonëse prezumimi që deduktohet nga aktet tregon të kundërtën – palët kishin parashikuar hapat formalë që do të ndërmerreshin nëse do të nevojitet revokimi për çfarëdo arsye -- sipas dakordësisë së shprehur në kontratë. Së treti, edhe versioni i fakteve të prezantuara nga subjekti gjatë procesit për të kontestuar këtë kontratë nuk rezulton i logjikshëm në kushtet kur pretendohet që rikonstruksioni të jetë marrë përsipër në vitin 2003 nga shitësja, e cila e kishte humbur të drejtën e pronësisë që në tetor 2002. Me fjalë të tjera, pavarësisht prej një akti noterial të kohës, i cili për palët ka fuqinë e ligjit dhe në mungesë të veprimeve të parashikuara për ta anuluar, prezumohet të jetë respektuar prej tyre apo përpos faktit që konfirmohet pagesa e një vlere konkrete/specifike, përpara dhe pasi i përllogaritet edhe TVSH-ja, dhe pavarësisht faktit që palët kanë pranuar shprehimisht që është paguar në atë datë nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e porositëses, Komisioni ka zgjedhur të pranojë një vlerë shpenzimesh më të ulët, favorizuese për subjektin. Komisioni ka pranuar shpjegimet jobindëse dhe alogjike të subjektit dhe duke referuar si bazë shkresa të thjeshta, deklarative, të cilat nuk ofrojnë asnjë element besueshmërie për kohën kur janë dakordësuar apo nëse pasqyrojnë realitetin e shpenzimeve të përballuara nga subjekti.

10.9. Në këtë kontekst dhe në vijim të kësaj analize, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se investimi në vlerë të konsiderueshme, pavarësisht nëse ka qenë ristrukturim i ndërtesës ekzistuese apo me shtesë kati, mbetet versioni më i besueshëm. Në këtë vlerësim, mbahet në konsideratë edhe që sipas planrilevimit të sjellë nga subjekti [si pjesë e kundërpadisë në konfliktin gjyqësor me Komunitetin Mysliman Shqiptar/Myftininë Durrës], referohet në shënimet sqaruese se *banesa e vjetër është ristrukturuar duke u bërë me tre kate*. Ky fakt rezulton edhe nga burimet e hapura, ku kati i tretë në fakt rezulton qartë të jetë kat standard/i plotë pavarësisht nga veshja e jashtme³⁷. Nga ana tjetër, sipas çmimeve të referencës për vitin 2002 për qytetin e Durrësit, do të rezultonte një vlerë shumë më e lartë për pasurinë³⁸ sesa 2 milionë lekë që ka qenë çmimi i shitjes. Me fjalë të tjera, subjekti mund të ketë blerë banesën në një gjendje që e bënte të domosdoshëm ristrukturimin, që gjithsesi e bën jobindëse situatën e përllogaritjes së investimit në vlera minimale, sikurse pretenduar prej saj. Me fjalë të tjera, çmimi nën atë të referencës në blerje është në kontradiktë me vlerën e ulët të rikonstruksionit dhe detajet

³⁷ Koordinatat nga Google Earth:

[***](#)

³⁸ Sipas Udhëzimit nr. 3, datë 16.10.2002, të EKB-së “Për çmimet e shitblerjes së pasurive të paluajtshme në tregun e lirë të apartamenteve” [jo truall+ndërtesë], në qytetin e Durrësit, çmimi i publikuar është 65.361 lekë, që nënkupton 4.682.462 lekë.

e paraqitura në aktet që paraqesin llojin e punimeve. Këto dy vlera do të bënin kuptim logjik në shpërpjesëtim me njëra-tjetrën: çmimi i ulët nënkupton nevojën për ristrukturim të kushtueshëm dhe anasjelltas. Subjekti pretendon dhe Komisioni i ka pranuar të dy këta aspekte në paralel dhe jo përjashtues të njëri-tjetrit, edhe nën dritën e vendndodhjes së shtëpisë në një zonë me rëndësi të spikatur kulturore, që logjikisht shoqërohet me kërkesë e kosto të shtuara. Në kushtet kur subjekti pretendon se e kreu rikonstruksionin kundrejt vlerës së situacionit të sjellë në hetimin administrativ, është e pashpjegueshme përse iu nevojitën dy kredi, në ekuivalentin në total të vlerës prej përrreth 2.8 milionë lekë, marrë nga NBG-ja [referuar më sipër], në harkun kohor mars 2003 - nëntor 2004 për ndërtim.

10.10. Në asnjë rast, vlera e deklaruar e pasurisë në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën e parë të vitit 2003 (3.4 milionë lekë) nuk është shumatorja e vlerës së përcaktuar në kontratën e blerjes së pasurisë [2 milionë lekë], me vlerën e kredive të rikonstruksionit. Në këtë logjikë, vlera e deklaruar e pasurisë nga subjekti është 3.4 milionë lekë dhe nuk ka përfshirë vlerën e rikonstruksionit [të cilën subjekti nuk e deklaroi në asnjë moment]. Nëse qëllimi i subjektit do të ishte deklarimi në këtë linjë, pra të vlerës së pasurisë së bashku me rikonstruksionin, atëherë subjekti duhet të kishte deklaruar 2 milionë lekë [vlera e pasurisë] dhe 25.000 USD [vlera e rikonstruksionit sipas kredive], që është afërsisht 4.5 milionë lekë.

10.11. Nga ana tjetër, shpjegimi i subjektit se vlera e deklaruar përfshin çmimin e blerjes dhe rikonstruksionin, sikurse pranuar nga Komisioni, nënkupton që deklarimi në deklaratën e parë periodike të vitit 2003 [dorëzuar më datë 25.03.2004], është i pasaktë. Gjithsesi, nën dritën e kontradiktave të shpeshta për vlerën e pasurisë, atë të investimit, të mënyrës së krijimit, të faktit që subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë se sa është realisht sipërfaqja e ndërtimit në këtë banesë apo se sa realisht është sipërfaqja e rikonstruktuar, qoftë nëse pasuria përlllogaritet në vlerën e deklaruar prej 3.4 milionë lekësh apo atë që do të rezultonte nëse hetimi do të bazohej mbi aktet e kohës, konstatohet se qëndron balanca negative për krijimin e saj. Balanca do të thellohej në mënyrë të konsiderueshme nëse Komisioni nuk do të bazonte analizën në pretendimet deklarative të subjektit³⁹.

10.12. Pavarësisht nga sa sipërkonstatohet, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi të mos ndalej në arsyetim më tej për realitetin financiar të investimit në këtë pasuri, në kushtet që Komisioni ka pranuar gjithë pretendimet deklarative të subjektit dhe garancitë procedurale në ankim e pamundësojnë një vlerësim përtej kontrollit të vendimit objekt ankimi. Trupi gjykues thekson se balanca negative e përfutur nga analiza e Komisionit, bazuar në pretendimet e subjektit që bien në kundërshtim me aktet e kohës, përbën vetëm një pjesë të pasurisë, si dhe të balancës negative që do të rezultonte nëse analiza do të mbështetej në aktet dokumentare dhe orientimet në vijimësi të Kolegjit. Gjithsesi, theksojmë që aspektet e vlerësimit të pasurisë objekt analize, që nuk janë bërë pjesë e konkluzionit të Komisionit, nuk do të ishin përcaktuese për zgjidhjen e çështjes pasi masa disiplinore e shkarkimit u konfirmua edhe në Kolegj. Ky vlerësim paraqet interes vetëm në vijim të analizës së trupit gjykues të Kolegjit në hyrje të këtij vendimi përse masa disiplinore

³⁹ Analiza financiare e kryer në Kolegj, sipas akteve në fashikull, e kryer në kontroll të analizës së Komisionit përftoi një balancë negative për vitin 2003 në vlerën prej përrreth (-) 2.8 milionë lekësh, për të përballuar shpenzimet dhe investimin, duke mospërlllogaritur vlerën e plotë të blerjes, e pranuar "huan" 1.4 milion lekë nga shitësja e shtëpisë.

për subjektin nuk mund të argumentohet se është disproporcionale, në kushtet që nënvizon se Komisioni ka qenë favorizues ndaj subjektit.

10.13. Pavarësisht nga ky konstatim, në analizë integrale të pretendimeve të subjektit, parë në kontekst të besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, sipas kriterëve ligjore të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit vëren që subjekti i rivlerësimit paraqitet jobindëse, kontradiktore dhe me pretendime që janë pasojë e nevojës për të përmirësuar situatën dhe jo domosdoshmërisht si pasqyrim i së vërtetës. *Së pari*, ky konstatim është rrjedhojë e faktit që ndonëse është pyetur të saktësojë në Komision totalin e sipërfaqes së rikonstruktuar apo të shtuar dhe regjistrimin e saj, subjekti nuk u përgjigj asnjëherë konkretisht, duke zgjedhur në formë të përgjithshme të deklarojë se ka rikonstruktuar vetëm banesën ekzistuese dhe se nuk ka pasur *zmadhim* të sipërfaqes. Ky shpjegim bie ndesh me faktin që vlera e preventivit të punimeve, sipas aktit të kohës dhe dakordësuar prej saj në kontratën e sipërmarrjes [3.884.700 lekë], përfshinte si punime në mënyrë të shprehur edhe *prishjen e banesës ekzistuese*.

10.14. Këto fakte marrin rëndësi në kushtet që gjatë hetimit administrativ ka rezultuar edhe informacion i detajuar lidhur me një konflikt të tejzgjatur civil mes subjektit dhe një ndër institucioneve të kultit në Shqipëri [Komuniteti Myslyman, Myftinia Durrës], nga i cili kanë ardhur në vëmendje të institucioneve të rivlerësimit fakte që sugjerojnë që subjekti mund të ketë ndërtuar një banesë krejtësisht të re, në një ndër zonat ekskluzive të trashëgimisë kulturore në Shqipëri⁴⁰, sikurse është amfiteatri romak i Durrësit⁴¹, monument kulture që në vitin 1973 dhe aktualisht në fokus të disa projekteve restauruese e ndërgjegjësuere⁴². Në kushtet që Komisioni nuk ka hetuar për kriterin profesional dhe as për ligjshmërinë e ndërtimit të kryer nga subjekti në një zonë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore rajonale, Kolegji mbetet vetëm të konstatojë këto problematika si *obiter dictum*, pa i shoqëruar ato me konkluzione në vlerësimin konkret të shkaqeve të ankimit, në respektim të garancive procedurale të palëve në ankim.

10.15. Të dhënat që rezultojnë nga sa më sipër, parë nga këndvështrimi i perceptimit që përcjell në publik mënyra sesi subjekti është sjellë në zgjedhjet pasurore të saj, qoftë parë në kontekstin e konfliktit civil, për shkak të mos shlyerjes së detyrimeve kontraktore si qiramarrëse me një person juridik publik, që lënë vend për dyshime për zaptim prone apo edhe dyshimet për përdorimin e një lejeje të lëshuar për një objekt tjetër, për të mundësuar një ndërtim tërësisht të ri, trekatësh në territorin e amfiteatrit të Durrësit, në një kontekst tjetër procedural, do të kishin passjellë peshë me rëndësi. Nga ana tjetër, për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi ato thjesht në drejtim të vlerësimit të besueshmërisë në kriterin e pasurisë së subjektit, në funksion të termave financiare, e konkretisht në drejtim të mbulimit më burime të ligjshme të shpenzimeve që shoqërojnë një investim të këtij karakteri.

10.16. Në referim të akteve në dosje dhe analizës së mësipërme, rezulton se çfarëdo vlere shpenzimesh e investimi të përllogaritet për shtëpinë objekt analize, qoftë si analizuar nga Komisioni apo bazuar në dokumentacionin ligjor në fashikull, mbi të cilin u analizua në Kolegji, subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë, sipas

⁴⁰ Referuar nga shkresa nr. {***} prot., datë 01.07.2003, e Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës. Sipas kësaj shkrese, subjekti ka ndërtuar pa leje një strukturë të re ose minimalisht shtuar kat.

⁴¹ <https://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2024/09/Qarku-Durres.pdf>

⁴² Shih, ndër të tjerë, faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës në www.kultura.gov.al.

shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Kjo mungesë sipas analizës së Kolegjit, është afërsisht (-) 2.8 milionë lekë, nga 572 mijë lekë (afërsisht) të konkluduar nga Komisioni. Sidoqoftë, në kuadër të parimit të mospërkeqësimit të situatës në ankim – *non reformatio in peius*, Kolegji mbeti në vlerat e konstatuara nga Komisioni.

C.2 Shpenzimet e mobilimit

10.17. Komisioni e ka kryer analizën financiare për shpenzimet e mobilimit të pasurisë së sipëranalizuar për periudhën 1993-2008, për të verifikuar mundësinë e subjektit për blerjen, rikonstruksionin dhe mobilimin. Balanca negative prej (-) 572.000 lekësh afërsisht [(-) 571.974 lekë, referuar në faqet 14 dhe 24 si shumatore e viteve 2005, 2007 dhe 2008]. Komisioni përlllogariti një shpërndarje të shumës prej 800.000 lekësh për mobilimin e banesës trekatëshe, të deklaruar nga subjekti. Shpërndarja e shpenzimeve ndër vite është në masën 60% në vitin e parë pas përfundimit të rikonstruksionit dhe pjesa tjetër e shpërndarë në tre vitet në vijim.

10.18. Subjekti pretendon se rezultati negativ i analizës financiare të viteve në fjalë është pasojë e interpretimit të gabuar të ligjit dhe provave nga Komisioni, pasi nuk ka marrë në konsideratë shpërndarjen e shpenzimeve të mobilimit, sipas versionit të paraqitur prej saj. Konkretisht, subjekti pretendon se ka kryer 70% të mobilimit gjatë vitit 2004, kur edhe ka marrë kredi [10.000 USD], dhe ka zgjatur deri në vitin 2008⁴³, sipas një table të depozituar prej saj, në përgjigje të rezultateve të hetimit.

10.19. Bazuar në analizën e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se analiza financiare e kryer nga Komisioni për këtë zë është e drejtë, ndërsa pretendimi i subjekti i pabazuar. Edhe nëse analiza kryhet duke baraspjesëtuar shpenzimet e mobilimit, mbetet një balancë negative për vitet 2007-2008. Ky konstatim është duke abstraguuar nga sa është arsyetuar gjerësisht më sipër, për pranimin pretendimeve deklarative të subjektit në vijimësi nga Komisioni dhe një analizë mbi bazë aktesh do të sillte një bilanc negativ të thelluar. Pa ripërsëritur sa është referuar gjerësisht, nën dritën e garancive procedurale me ankimin, trupi gjykues, edhe në këtë zë të analizës, rithekson konfirmimin edhe në Kolegji të një balance negative, minimalisht në vlerën e konstatuar gjatë hetimit administrativ në Komision. Konkluzioni i mësipërm i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në detaj në vijim.

10.20. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se mobilimi dhe pajisjet elektrike kanë kushtuar përafërsisht 800.000 lekë dhe ka nisur në vitin 2004 [pyetësori nr. 1], ndërsa rikonstruksioni i vazhdoi deri në vitin 2005 [pyetësori nr. 3]. Në pyetësorin nr. 4, subjekti deklaroi se shpenzimet për mobilim janë kryer nga viti 2004 deri në vitin 2016, por nuk mbante mend sa kanë qenë shpenzimet për çdo vit. Në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe në ankim, subjekti duket se e vendos shpenzimin për mobilimin e shtëpisë në harkun kohor 2004-2008. Komisioni ka arsyetuar se shpenzimet e mobilimit për nga natyra kryhen pas përfundimit të rikonstruksionit – që nënkupton duke nisur nga një moment i caktuar kohor në vitin 2005, sipas deklarimit të subjektit. Megjithatë, meqenëse banesa ka disa kate, mobilimi mund të jetë kryer

⁴³ Subjekti pretendon se shpenzimet e mobilimit duhet të shtrihen: në vitin 2004-70%; në vitin 2005-20%; në vitin 2006-5% dhe në vitet e tjera (deri në vitin 2008) pjesën e mbetur. Ka theksuar edhe se në disa prej viteve pas vitit 2005, nuk ka bërë asnjë blerje për mobilim.

pjesë-pjesë e paralel me rikonstruksionin. Subjekti ka qenë konsistente për momentin e fillimit të mobilimit të banesës, nga viti 2004.

10.21. Në vijim të sa më sipër, edhe në arsyetimin e Kolegjit u gjet i bazuar qëndrimi i Komisionit, qoftë për kohështirjen e shpenzimeve të mobilimit të shtëpisë objekt analize, ashtu edhe për mënyrën e shpërndarjes së tyre, duke përlllogaritur 60% të vlerës si e investuar në vitin e parë. Ky koncept rezulton të jetë pranuar edhe nga subjekti, referuar tabelës së bashkëlidhur me ankimin e saj. Shpërndarja e shpenzimeve të mobilimit për 12 vjet, referuar indirekt në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, nëse ka pasur për fokus këtë pasuri, do të ishte qasje jo realiste për një shtëpi ku subjekti banon rregullisht. Në këtë linjë ka qëndruar Kolegji edhe në çështje të tjera, kur në fokus ka qenë shqyrtimi i shkaqeve të ankimit për analizën e shpenzimeve të paprovuara të mobilimit me dokumentacion. Megjithatë, edhe në alternativën që këto shpenzime do të baraspjesëtoheshin për katër vitet e para, balanca negative që i ka rezultuar Komisionit do të ulej vetëm lehtësisht, duke ndikuar vetëm mbi vitin 2005, ndërsa vitet 2007 dhe 2008 do të mbeteshin me balancë negative.

10.22. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit për përdorimin e likuiditeteve të disponuara nga kredia e akorduar në vitin 2004 nga NBG (10.000 USD), për mobilimin nuk është bindës, porë nga disa këndvështrime. *Së pari*, për herë të parë, subjekti është shprehur për përdorimin e tyre për mobilimin vetëm në ankim. Përkundër këtij pretendimi, në mënyrë konsistente, qoftë gjatë procesit që ka paraprirë marrjen e kredisë [qëllimin e marrjes së saj, sipas akteve dokumentare], ndër vite – nëpërmjet deklaratave periodike vjetore – si dhe në procesin e hetimit administrativ në Komision, subjekti e ka lidhur nevojën e marrjes apo përdorimin e fondeve të kredive me *rikonstruksionin* e shtëpisë. Edhe në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti e ka lidhur marrjen e kredive ngushtësisht me nevojën për rikonstruksionin e shtëpisë, duke shpjeguar ndryshe pamundësinë financiare për ta kryer atë me sipërmarrësin, me të cilin kishte lidhur kontratën noteriale përkatëse [kontrata me z. K., analizuar gjerësisht më sipër]. Investimi në një vlerë të konsiderueshme për blerjen e rikonstruksionin e shtëpisë në lagjen “{***}”, objekt analize, përfshirë edhe kreditë, u pranua si varianti më i logjikshëm edhe nga trupi gjykues i Kolegjit në arsyetim më sipër, pasi përkon me vlerën e pasurisë, kohën e krijimit të saj, sikurse edhe gjithë rrethanat e tjera të analizuara gjerësisht më sipër.

10.23. *Së dyti*, nëse fondet e mbetura të papërdorura nga kredia ishin në disponim të saj vite më pas, e konkretisht në vitet me rezultat negativ financiar, 2007 e 2008, gjendja e tyre *cash* në shtëpi nuk ka gjetur asnjë pasqyrim në deklaratat periodike vjetore. Në këto të fundit, subjekti ka deklaruar në mënyrë konsistente: kreditë e marra, asnjë ndryshim në pasuritë e paluajtshme dhe njëkohësisht asnjë shumë likuiditetesh jashtë sistemit bankar, në vitet kur pretendon që është shpenzuar për mobilimin. Për herë të parë, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në deklaratën për vitin 2012, duke referuar si burim kursimet nga paga. Për rrjedhojë, pa ripërsëritur arsyetimin e mësipërm, dhe duke shtuar edhe kontradiktat në deklaratimet e subjektit për specifikimin e shpenzimeve të kryera, vlerën e pasurisë, sipërfaqen, llojin dhe vlerën e punimeve të kryera në funksion të investimit, pretendimi i subjektit, për kredinë si burim financiar për mobilimin, u vlerësua si një përpjekje e saj për të përmirësuar balancat negative që rezultojnë gjatë vlerësimit të kriterit pasuror dhe në momentet kur ato rezultojnë.

10.24. Në përfundim, për pasurinë e analizuar në këtë rubrikë, *banesë private në lagjen nr. {***}, rruga "{***}"*, në Durrës, blerë në vitin 2002, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, në kuptim të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Ndonëse vlera reale e pasurisë në analizën integrale të gjithë aspekteve që rezultojnë të provuara nga aktet shkresore është më së paku 3.4 milionë lekë, që përkon me vlerën e deklaruar prej subjektit në deklaratën e parë të pasurisë së vitit 2003, edhe analiza e Komisionit, e cila pasqyron versionin më të mirë të mundshëm të analizës financiare për subjektin për këtë pasuri, paraqet një situatë të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe përballimin e shpenzimeve të kryera për rikonstruksionin, që u konfirmua edhe në vlerësimin e kryer në Kolegj. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të pabazuara në prova.

C.3. Automjeti tip “Mercedes-Benz ML”, blerë në datën 29.01.2010

11. Pasuria e dytë, për të cilën Komisioni ka konstatuar mungesë burimesh të ligjshme për ta krijuar dhe që është shkak mbi të cilin bazohet masa disiplinore e shkarkimit, është dhe automjeti në fjalë, blerë më 29.01.2010, në vlerën 6.000 euro. Komisioni arsyetoi se subjekti nuk provoi disponimin si paradhënie të shumës 7.000 euro nga blerësi i automjetit, shitjen e të cilit⁴⁴, subjekti e ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*. Subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri likuiditetesh për ta mbuluar vlerën e blerjes me burime të ligjshme. Për këtë shkak, Komisioni konkludoi se subjekti gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë. Në vendim nuk ka asnjë referencë tek sa ka rezultuar balanca negative për krijimin e kësaj pasurie, por në analizën përmbledhëse të faqes 24, balanca negative e vitit 2010, Komisionit i ka rezultuar në vlerën (-) 900.000 lekë afërsisht. Nga ana tjetër, në konkluzionin përfundimtar, Komisioni nuk është shprehur për konflikt të mundshëm interesi me blerësin e automjetit në pronësi të subjektit nga viti 2008 deri në vitin 2010, për të cilin ajo ka shqyrtuar tre çështje gjyqësore. Komisioni ka hetuar për këtë dyshim duke marrë shkas nga çmimi i shitjes së automjetit këtij individ që duket jo real. Komisioni shprehet kalimthi në vendim që, edhe nëse do të pranoheshin të ardhurat e fituara nga paradhënia, ato nuk mund të përfshihen në analizë pasi nuk i janë nënshtruar tatimit mbi fitimin.

11.1. Në ankim, sikurse edhe në Komision, subjekti pretendon se ka marrë një vlerë prej 7.000 eurosh si paradhënie nga blerësi i automjetit të mëparshëm në pronësi, ndërsa kontrata e shitjes së këtij mjeti është finalizuar më pas. Po ashtu, ajo parashtrohet se nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit me blerësin e automjetit, pasi koha mes transaksionit të shitjes së automjetit dhe gjykimeve ishte shumë e gjatë. Së treti, subjekti kërkon që në analizën financiare të burimeve të ligjshme të përfshihen një pjesë e të ardhurave nga shitja, e konkretisht ajo që rezulton të mbetet pasi i zbritet fitimi i gjeneruar nga diferenca me blerjen. Sipas saj, nëse analiza kryhet në këtë metodë, pamjaftueshmëria e burimeve për blerjen e automjetit objekt analize do të reduktohet në 1.000 euro, vlerë e cila nuk mund të shërbejë si shkak për shkarkim nga detyra. Së fundmi, subjekti kërkon që në analizën financiare për mundësinë e krijimit të kësaj pasurie në janar 2010 të përfshihet edhe paga e muajit dhjetor 2009. Bashkërisht këto veprime do të passillnin balancë pozitive të ardhurash, të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

⁴⁴ Subjekti e ka blerë automjetin “Volkswagen Golf”, në vitin 2008 dhe e ka shitur më 22.02.2010.

11.2. Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ndërsa pretendimet për fitimin e shumës prej 7.000 eurosh, thuhet se një muaj përpara shitjes së automjetit, janë të natyrës deklarative, pasi bien ndesh me aktet që kanë peshën e provës. Nga ana tjetër, pretendimet dhe shpjegimet e subjektit për të argumentuar mungesën e konfliktit të interesit me blerësin, duke qenë se nuk kanë si pikënisje konkluzionin përfundimtar të Komisionit për këtë pasuri, u vlerësua të mos i nënshtrohen shqyrtimit të detajuar të trupit gjykues të Kolegjit, pasi nuk janë përcaktuese në vendimmarrjen objekt ankimi. Në vijim, shtjellohet arsyetimi i trupit gjykues mbi të cilin bazohet ky konkluzion.

11.3. Nga aktet në fashikull rezulton që subjekti ka deklaruar këtë automjet në deklaratën *vetting* me vlerë 6.000 euro, së bashku me shpenzimet doganore 356.842 lekë, shpenzimi i kryer për këtë automjet arrin në ekuivalentin e 1.184.602 lekëve, sipas konvertimit të kryer në analizën e Komisionit. Sipas përkthimit të faturës së shitjes, vlera 6.000 euro u pagua *në dorë* në këtë datë [më 25.01.2010], ndërsa detyrimet doganore janë shlyer katër ditë më pas. Nga ana tjetër, automjeti [Volkswagen Golf], shitja e të cilit referohet si burim krijimi, është blerë në vitin 2008 kundrejt çmimit 3.000 euro dhe 242.000 lekë (afërsisht, vlera e detyrimit doganor) ose në total ekuivalenti i 607.215 lekëve. Subjekti e ka shitur këtë automjet në datën 22.02.2010 kundrejt çmimit 9.000 euro. Qartazi, mes blerjes dhe shitjes së këtij automjeti ka një diferencë financiare nga e cila subjekti ka gjeneruar fitim në vlerën 640.000 lekë, pasi ka shitur një automjet të përdorur me çmim më të lartë sesa ai i blerjes, edhe pasi e ka përdorur automjetin nga data 30.07.2008 deri në shkurt 2010, thuhet se 19 muaj.

11.4. Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se konstatimet e Komisionit janë të bazuara për faktin që subjekti ka përfituar një vlerë më të lartë sesa ajo e shpenzuar për automjetin, sikurse edhe përfitimi i shumës prej 7.000 eurosh, paradhënie nga blerësi, nuk u provua në asnjë formë, duke mos i dhënë peshë provuesë deklaratës noteriale të hartuar, pasi subjekti u njoh me rezultatet e hetimit. Përpos këtyre konstatimeve të Komisionit të cilat i vlerësoi të bazuara, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë edhe aspekte të tjera të cilat rezultojnë nga analiza e akteve në fashikull e që dëshmojnë problematika të besueshmërisë së variantit të fakteve të pretenduara nga subjekti.

11.5. *Së pari*, subjekti nuk e ka specifikuar në deklaratën periodike të vitit/viteve përdorimin e të ardhurave nga shitja e automjetit si burim për krijimin e automjetit të deklaruar në deklaratën *vetting*. Çfarë është më e rëndësishme në procesin e rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, subjekti ka dhënë vlerë të cunguar të shpenzimit të kryer, në kushtet që nga ekuivalenti i rreth 1.2 milion lekëve ka deklaruar vetëm ekuivalentin e rreth 57% të saj [vlerën 6.000 euro]. Pjesa tjetër e shpenzimit, prej rreth 43% të tij, detyrimi doganor, nuk ka gjetur asnjë pasqyrim në deklaratën *vetting*. Komisioni nuk e ka konstatuar këtë fakt që rezulton nga një analizë e thjeshtë e të dhënave, duke u fokusuar në konfliktin e interesit me blerësin apo mospagimin e detyrimeve tatimore për fitimin e gjeneruar, përpos çmimit në pamje të parë jo real të shitjes.

11.6. *Së dyti*, konstatimi i Komisionit për natyrën deklarative të pretendimeve të subjektit për fitimin e shumës 7.000 euro, përpara se të ndodhte shitja, qëndron. Pretendimet e subjektit se ka fituar likuiditete të barasvlershme me 77% të vlerës së mjetit, thjesht duke i dorëzuar blerësit [z. I. M.], vetëm *çelësin e automjetit por jo vetë automjetin*, ndonëse ai *e kërkonte me urgjencë*, pasi *e kishte parë në lavazh* – sikurse ajo është shprehur në seancën dëgjimore në Komision – janë jo

vetëm kontradiktore me shpjegimet e tjera të saj për nivelin e njohjes me blerësin (vetëm te noteri kur shiti mjetin)⁴⁵ apo faktin që ka gjykuar tre çështje në të cilat ky individ ka rezultuar palë gjyqfuese dhe, mbi të gjitha, me faktin që subjekti e ka kërkuar zotin M. si dëshmitar në Komision, në lidhje me gjendjen e banesës së familjes së saj. Sipas asaj kërkesë, z. M. referohet si banor i pallatit ku ajo dhe vëllezërit janë bashkëpronarë në një apartament të fituar nga privatizimi⁴⁶.

11.7. Nga ajo kërkesë e dërguar Komisionit, rezultojnë rrethana të tjera të paqarta. Në kushtet që Komisioni nuk është ndalur në çfarë përfaqësojnë individët në fjalë në panoramën e jetës financiare të subjektit, trupi gjykues çmon t'i sjellë ato në vëmendje vetëm në drejtim të besueshmërisë së pretendimeve të subjektit. Konkretisht, nga kërkesa për të thirrur disa dëshmitarë, drejtuar Komisionit më 25.02.2021, lidhur me një pasuri tjetër të saj në bashkëpronësi, subjekti rezulton, më së paku pretendon, të jetë fqinjë me disa nga personat që në pasurinë e sipëranalizuar – shtëpia në lagjen “{***}” -- paraqiten në cilësi të ndryshme, përfshirë huadhënëse dhe shitëse [znj. F. B., e cila në deklaratën noteriale gjatë rivlerësimit pretendon se nuk njihet me subjektin deri në momentin e shitjes së shtëpisë], inxhinierin që ka “marrë përsipër” të kryejë rikonstruksionin [z. Sh.], dy individët që pretendohet se e kanë kryer rikonstruksionin [z. F. dhe z. R. R.] dhe djali i sipërmarrësit fillestar, kontrata me të cilin nuk u zbatua, i cili po ashtu ka lëshuar një deklaratë noteriale në favor të subjektit [z. E. K.].

11.8. Duke iu kthyer pasurisë objekt analize, mospërputhjet logjike që rezultojnë nga përshkrimi që subjekti bën për rrethanat e shitjes së automjetit në 2010, me faktin që për herë të parë subjekti ka pretenduar parapagimin e automjetit, vetëm pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, nëpërmjet deklaratës noteriale të lëshuar nga z. M./blerësi, 10 vite pasi kishte ndodhur shitja e automjetit, pretendimet e subjektit janë krejtësisht deklarative e jobindëse. Duke abstraguat nga fakti që nëpërmjet kësaj deklarate pretendohet dhënia e 77% të çmimit pa asnjë garanci një të panjohurë – sikurse përmbledhur më sipër nga pretendimet e subjektit – që paraqesin inkoherenca në thelb në kushtet që blerësi u mjaftua me marrjen e çelësit kundrejt pagesës së 7.000 eurove, kjo mënyrë të vepruari si element sigurie, e pashoqëruar me dokumentacion e pa u referuar as në kontratën e shitjes, është në vetvete po ashtu aspekt që e bën pretendimin e subjektit të pakuptimtë e të pabesueshëm. Me fjalë të tjera, subjekti pretendon një situatë të zhbalancuar e në favor të njëkahshëm – në drejtim të saj – sipas së cilës ajo formalizoi shitjen vetëm pasi mori gjithë vlerën nga blerësi, ndërsa nuk ia ofroi e mundësoi një standard të barabartë sigurie palës tjetër në transaksion, në kushtet që ai shleu detyrime të konsiderueshme për të cilat palët nuk lanë asnjë gjurmë.

⁴⁵ Shpjegim i dhënë, po ashtu, në të njëjtën seancë dëgjimore në Komision.

⁴⁶ Kërkesa e subjektit gjatë hetimit administrativ, më datë 25.02.2021, dërguar Komisionit. Ndër të tjera, subjekti, nëpërmjet saj, ka kërkuar të pyeten si dëshmitarë për gjendjen e banesës së prindërve/vëllezërve të subjektit, banorët e pallatit në bashkëpronësi me vëllezërit, konkretisht: (1) F. B.; (2) E. K.; (3) L. SH.; (4) R. R.; (5) F. R.; dhe (6) I. M.. Të gjithë këta persona shfaqen në transaksione të tjera me subjektin. Konkretisht, znj. F. B. ka shitur shtëpinë në lagjen {***} [analizuar më sipër] dhe dhënë hua subjektit. Z. E. K. ka lëshuar deklaratën noteriale nëpërmjet të cilës shprehet se kontrata e sipërmarrjes me të atin [inxhinierit SH. K.] nuk u realizua, analizuar më sipër; L. SH. ka hartuar preventivin e punimeve të rikonstruksionit të banesës private, sipas pretendimeve të subjektit, ndërsa F. e R. R. kanë kryer punime, sipas pretendimeve të subjektit; I. M. ka blerë automjetin, transaksion nga i cili subjekti ka krijuar rreth 4 mijë euro fitim pas dy vjetësh, përpos tri proceseve gjyqësore në të cilat ka gjykuar subjekti e ai ka qenë palë gjyqfuese.

11.9. Për sa më sipër, në kushtet që shitja e automjetit dhe përfitimi i vlerës 9.000 euro, rreth një muaj pasi subjekti ka shlyer pagesën për automjetin objekt analize dhe, nën dritën e aspekteve të sipëranalizuara që e bëjnë situatën e pretenduar prej saj të pabesueshme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit në ankim janë të pabazuara në ligj e në prova dhe konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Në kushtet kur shitja e automjetit, që subjekti ka referuar në procesin e hetimit administrativ, ndodhi pasi është blerë pasuria objekt analize, të ardhurat nga ai transaksion nuk mund të shërbenin për të krijuar një pasuri të blerë disa javë më herët. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në një fazë të avancuar të hetimit administrativ për pagesën e kryer nga blerësi përpara hartimit të kontratës së shitjes, u vlerësuan jobindëse e të pabazuara në dokumentacion ligjor. Për sa u analizua, pas kryerjes së kontrollit të analizës financiare të Komisionit, edhe në Kolegj rezultoi se subjekti i rivlerësimit u gjend në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

11.10. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të mos ndalet në arsyetimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit nëse ajo ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit me z. Ismail Meçe, të cilit i ka shitur automjet dhe gjeneruar fitim prej rreth 4.600 euro [apo rreth 640.000 lekë ekuivalent], pas thuajse dy vitesh përdorimi. Në kushtet që vendimi i Komisionit për këtë pasuri konkludon vetëm në drejtim të *mungesës* së burimeve, analiza e konfliktit të interesit është jo përcaktuese dhe e panevojshme edhe për ekonomi gjyqësore. Pavarësisht nga ky qëndrim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, për mungesë besueshmërie të shpjegimeve të subjektit në tërësi apo marrëdhënien me këtë individ në veçanti, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që Komisioni nuk e ka zgjidhur drejt kontekstin në të cilin e ka analizuar këtë aspekt. Çështja e konfliktit të interesit do të duhet të ishte shtruar dhe vlerësuar nga Komisioni duke ngritur pyetjen nëse subjekti ka gjykuar konflikte gjyqësore në të cilët ajo kishte marrëdhënie miqësore me njërin palë [z. M.], i cili ka rezultuar gjyqëfitues⁴⁷, në kushtet që gjatë hetimit për pasurinë tjetër, ky person kërkohet të dëgjohet si dëshmitar e fqinjë, në favor të rrethanave faktike të pretenduara prej saj. Është i pakuptimtë e i pabazuar hetimi i kryer nga Komisioni për tri çështjet e shqyrtuara nga subjekti – dy prej të cilave janë gjykuar përkatësisht tetë (8) dhe tre (3) vite përpara shitjes së automjetit e, për pasojë, *as teorikisht* nuk mund të përbëjnë konflikt interesi gjatë ushtrimit të detyrës⁴⁸, pasi shitja e mjetit nuk kishte ndodhur ende – duke abstraguat edhe nga fakti që ligji nr. 9367/2005 nuk ekzistonte gjatë gjykimit të parë, në vitin 2002. Në vijim, analiza mund të shtrohej nën dritën e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile apo ligjit nr. 9367/2005, sipas rastit. Subjekti nuk është pyetur të shpjegojë nivelin e njohjes/miqësisë me këtë individ në momentin kur ka marrë vendimin e parë [në vitin 2002] apo për të shpjeguar arsyet përse ai ka zgjedhur të blejë një automjet me një vlerë më të lartë sesa ajo e shpenzuar nga subjekti dy vite më parë.

⁴⁷ Referuar faqes 16 të vendimit të Komisionit, subjekti ka gjykuar dhe dhënë tri vendime gjyqësore civile në favor të këtij personi si palë ndërgjyqëse: më 29.10.2002, vendimi nr. {***}, i Gjykatës së Rrethit të Durrësit, më 28.05.2007, vendimi nr. {***}, i së njëjtës gjykatë dhe më 28.07.2020, vendimi nr. {***}, i së njëjtës gjykatë.

⁴⁸ Neni 3, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave” parashikon që: “[...] 1. “Konflikti i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike. [...]”.

11.11. *Së fundmi*, edhe argumenti tjetër i subjektit, bazuar në mospagimin e tatimit për fitimin e gjeneruar nga shitja e automjetit, është po ashtu pa peshë përcaktuese e i panevojshëm për t'u analizuar. Në kushtet që konkluzioni i vetëm i Komisionit për pasurinë objekt analize është *mungesa e burimeve të ligjshme* për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie⁴⁹, ndërsa mospagimi i tatimit pavarësisht se përmendet kalimthi nuk duket të ketë gjetur vend në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i panevojshëm arsyetimi i mëtejshëm në këtë këndvështrim.

11.12. Në përmbledhje të sa më sipër, në analizën e kryer në Kolegj në funksion të shkaqeve të ankimit, konfirmohet mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë automjet në janar 2010 në vlerën ekuivalente të 1.184.602 lekëve. Pretendimet e subjektit në një fazë të avancuar të procesit të hetimit administrativ se ka marrë paraprakisht një pagesë për një transaksion të kryer më pas në kohë, u gjetën të pabazuara. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga shkronja “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 edhe për krijimin e kësaj pasurie.

C.4. *Apartament me sipërfaqe 102 m², në {***}, Durrës*

12. Pasuria tjetër për të cilën Komisioni ka konstatuar problematikë të mjaftueshme për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi është apartamenti me sipërfaqe 102 m², që ndodhet në zonën e plazhit, në {***}. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting*. Pas analizës financiare, Komisioni konkludoi se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve për pagesat e kryera, në total në shumën (-) 3.830.636 lekë dhe, për rrjedhojë, në kushtet e pamjaftueshmërisë të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie. Ky konkluzion mbajti në konsideratë faktin që burimet e deklaruara për pagesat e dy kësteve nuk mund të shërbenin për të mbuluar vlerën e paguar, pasi subjekti nuk kishte deklaruar kursime në *cash* në deklaratat periodike deri në vitin 2012 dhe burimi tjetër i deklaruar, pensioni i nënës, ka vijuar të jetë në llogari i patërhequr, edhe pasi subjekti pagoi këstin e dytë të apartamentit. Për pasojë, nuk mund të jetë përdorur për sa deklaruar.

12.1. Subjekti pretendon se pasuria e saj nuk e kalon kufirin e dyfishit të pasurisë së ligjshme, si dhe nuk konstatohet fshehje apo deklarim i rremë e nuk mund t'i caktohet barrë prove. Po ashtu, subjekti pretendon edhe që Komisioni ka mbajtur standard të ndryshëm në rastin e saj lidhur me deklarimin e likuiditeteve *cash*⁵⁰, për të cilat vendimet kanë marrë formë të prerë, duke vendosur standard të pranuar nga institucionet e rivlerësimit. Sipas subjektit, Komisioni në raste të mëparshme ka konkluduar se nëse provohet mundësia e krijimit të gjendjeve *cash* të padeklaruara në deklaratat periodike, subjekti të përjashtohet nga përgjegjësia disiplinore nëse këto vlera janë deklaruar saktësisht në deklaratën *vetting*. Komisioni duhej t'i kishte njohur këto kursime si burim të ligjshëm për krijimin e pasurisë në fjalë, meqenëse subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* se burimi i krijimit të pasurisë janë kursimet ndër vite nga të ardhurat e saj. Subjekti argumenton se Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë shpjegimet e saj gjatë hetimit administrativ, për pagesën e kështit të dytë që kishte si burim fondet e transferuara nga i vëllai për një shtesë të shtëpisë së tij, që nuk u krye. Subjekti e përdori këtë shumë për të shlyer

⁴⁹Faqe 18, paragrafi 3.7, i vendimit të Komisionit.

⁵⁰Përmend vendimin nr. 105, datë 12.02.2019, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit Elsa Toska, cituar edhe më lart.

këstin e dytë të apartamentit, ndërsa fondet ia ktheu vëllait më pas, nga pensioni i nënës. Për të provuar këto pretendime, ka paraqitur edhe akte për treguar qenien e tij në Shqipëri në këtë periudhë. Subjekti kërkoi që të ribëhet analiza financiare e viteve 2012 e 2013, duke konsideruar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie.

12.2. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Edhe në vlerësimin e kryer në Kolegj në funksion të shkaqeve të ankimit, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme minimalisht në vlerën e konstatuar nga Komisioni, për secilin prej kësteve, por edhe sipas analizës së vitit, sikurse e ka referuar Komisioni në tabelën përfundimtare të vendimit, në faqen 23. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

12.3. *Së pari*, trupi gjykues çmon të rikonfirmojë arsyetimet e tij të mëparshme lidhur me mënyrën e interpretimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016⁵¹, barrën e provës që kanë subjektet e rivlerësimit në këtë proces, si dhe shkaqet mbi të cilat organet e rivlerësimit legjitimohen të marrin masën e shkarkimit nga detyra. Përpos sa është arsyetuar në detaj më sipër, në këtë arsyetim në analizën e shkaqeve të ankimit që lidhen me procesin e rregullt, zbatimin e dispozitave të neneve 6 dhe 8 të KEDNj-së, argumentet e parashtruara nga subjekti, të cilat kushtëzojnë shkarkimin me konstatimin e dyfishit të pasurisë apo fshehjen, janë të pabazuara. Situata e dyfishit të pasurisë së ligjshme është vetëm një ndër gjashtë (6) shkaqet ligjore që passjellin masën disiplinore të shkarkimit. Si të tilla, secila nga këto situata mund të sjellë në mënyrë autonome shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit. Secila prej këtyre situatave ligjore gjen pasqyrim e vjen në zbatim të dispozitave të ndryshme të Aneksit të Kushtetutës. Në rastin konkret, Komisioni ka vendosur shkarkimin e subjektit, pasi ka konstatuar se ajo nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurive, ka mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve dhe gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, bazuar në dispozitat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, shkronja “b” dhe 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

12.4. *Së dyti*, pretendimi i subjektit se barra e provës i kalon subjekteve vetëm nëse konstatohet gjendja e dyfishit të pasurisë, fshehje dhe/ose deklarim i rremë, është po ashtu i pabazuar dhe i pakuptimtë. Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 nuk e kushtëzojnë në asnjë formë apo dispozitë kalimin e barrës së provës me konstatimin vetëm të situatave ligjore që parashtron subjekti, përkundrazi. Neni C, pika 5 i Aneksit⁵² të Kushtetutës dhe neni 52 i ligjit nr. 84/2016⁵³ në mënyrë të shprehur përcaktojnë barrën e provës në procesin e rivlerësimit në ngarkim të subjekteve të rivlerësimit, përpos frymës së përgjithshme të tyre nga e cila deduktohet qartë detyrimi i subjekteve për të provuar të kundërtën e konstatimeve sipas rastit apo sjellë akte e

⁵¹ Shih, ndër të tjerë, në vendimin e Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit Albina Spaha (JR) nr. 1/2021; vendimin e Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit Çlirim Shahini (JR) nr. 26/2020; vendimin e Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit Nure Dreni (JR) nr. 9/2023; si dhe vendimin e Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit Silvana Pani (JR) nr. 28/2023.

⁵² “[5.] Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal”.

⁵³ “[2.] Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelimit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”.

prova e shpjeguar bindshëm. Fshehja, deklarimi i rremë dhe dyfishi i pasurisë janë vetëm tre situata në të cilat subjekteve u kalon barra e provës. Po ashtu, neni 30 i ligjit nr. 84/2016 në mënyrë të shprehur parashikon që objekt i vlerësimit të pasurisë është: *“Deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”*. Për rrjedhojë, edhe parë nën këtë aspekt, konkluzioni i Komisionit, pasi ka konstatuar deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë dhe ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre për subjektin e rivlerësimit, është i bazuar.

12.5. Së treti, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar edhe pretendimin tjetër të subjektit që tenton të kushtëzojë shkarkimin vetëm me konstatimin e dyfishit të pasurisë së ligjshme, pasi legjislatori ka dashur të amnistojë subjektet deri në atë nivel, për shkak të mosfunksionimit të administratës tatimore, informalitetit në Shqipëri e evazionit [fiskal] pas ndryshimeve të sistemit në vitet '90. Situata e mungesës së burimeve të ligjshme, konstatuar për subjektin për apartamentin në plazh, blerë në vitin 2013, nuk rezulton të ketë asnjë lidhje të dukshme apo të nënkuptuar me informalitetin fiskal, dhe as rezulton të jetë potencuar në ndonjë kontekst në ankim apo gjatë procesit të rivlerësimit. Në kushtet që të ardhurat e vetme të deklaruara nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie janë ato nga pagat si gjyqtare, të dokumentuara, tatuara dhe për të cilat janë shlyer gjithë detyrimet ndaj buxhetit të shtetit nga punëdhënësi i saj në vazhdimësi ky pretendim është i pakuptimtë e alogjik. I njëjti konstatim vlen edhe për burimin tjetër të deklaruar për krijimin e kësaj pasurie, pensionin e nënës, i cili paraqet të njëjtat karakteristika formale e tërësisht të dokumentueshme si paga e subjektit, përpos faktit që dokumentacioni bankar ka konfirmuar përtej çdo dyshimi që pensioni nuk mund të shërbente për këstin e parë, për sa kohë ka qenë i patërhequr edhe pasi është shlyer kësti i dytë.

12.6. Përpos sa më sipër, ritheksojmë që kjo pasuri është krijuar në vitin 2013. Subjekti kishte 10 vjet që ishte subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003 dhe ishte e ndërgjegjshme për detyrimet e saj për të deklaruar saktë çdo vit nën përgjegjësi ligjore. Në asnjë stad të problematikave të konstatuara për këtë pasuri, nuk rezulton të ketë mungesë informacioni apo cedime nga mënyra sesi funksionon administrata tatimore, e cila ka nisur të funksionojë më së paku që në vitin 1993⁵⁴. Në përmbushje të barrës së provës dhe të deklarimeve të saj, subjekti ka pasur detyrimin të justifikojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që ka deklaruar se i shërbyen për krijimin e saj, që sipas deklarimit ishin kursimet në shtëpi *cash* dhe pensioni i të ëmës. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit u vlerësua i pabazuar. Për më tepër, këto shkaqe ankimi, të ngritura nga subjekti vetëm për këtë pasuri, për të cilën informaliteti i pas viteve '90 nuk mund të argumentohet se ka ndonjë relevancë, u vlerësuan si një përpjekje e subjektit për të përmbysur rezultatin negativ të *spikatur* që ka rezultuar për këtë pasuri, pasi subjekti ka arritur të përmbysë me sukses një sërë problemesh serioze, në sajë të qëndrimit tejet favorizues të Komisionit, në vlerësimin e kriterit të pasurisë, për sa i përket banesës trekatëshe në zonën historike të Durrësit, analizuar gjerësisht më lart në këtë vendim.

⁵⁴ Ligji nr. 7677, datë 03.03.1993, *“Për tatimin mbi fitimin”*; ligji nr. 7681, datë 04.03.1993, *“Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”*; ligji nr. 7786, datë 27.01.1994, *“Për tatimin mbi të ardhurat personale”*; ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, e me radhë, me ndryshimet e shfuqizimet e legjislacionit që kanë pasuar deri në ditët e sotme.

12.7. Duke iu rikthyer themelit të vlerësimit të pasurisë objekt ankimi, nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri me sipërfaqe 102 m² në bashkëpronësi (25%), dhe të porositur me kontratën noteriale të sipërmarrjes⁵⁵, datë 04.04.2013. Vlera e pasurisë është 41.600 euro dhe, për sa i përket burimit të krijimit, subjekti ka specifikuar se ka shlyer vlerën 31.600 euro, nga të cilat 10.000 euro *kursime* nga llogaria e *pensionit* të nënës, si dhe *kursimet në vite, cash në shtëpi*. Në këtë deklaratë, subjekti ka bashkëlidhur edhe mandatpagesën e datës 27.06.2013, lëshuar nga BKT-ja, me përshkrimin sipas së cilit subjekti *ka derdhur* në llogari këstin e dytë të *kontratës së sipërmarrjes nr. {***}*, në vlerën 11.600 euro.

12.8. Nga aktet në fashikull, me fokus pagesat e dy kësteve për këtë pasuri, në vlerën 31.600 euro, rezulton sa vijon:

a. Në kontratën e sipërmarrjes, lidhur midis subjektit dhe investitorit [{"***"} ShPK], është përcaktuar se likuidimi i vlerës do të kryhej si vijon: (i) kësti i parë 20.000 euro likuiduar më datë 02.04.2013; (ii) kësti i dytë 11.600 euro do të likuidohet deri më datë 30.05.2013; si dhe (iii) kësti i tretë 10.000 euro do të shlyhej me kalimin e pronësisë në emër të porositësit.

b. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 dhe në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se vlera e shlyer prej 31.600 eurosh ka burim 10.000 euro nga llogaria bankare dhe kursimet në vite *cash* në banesë. Me fjalë të tjera, nga këto dy deklarime deduktohet se kursimet e pretenduara kanë qenë në shumën 21.600 euro në prill 2013.

c. Subjekti ka deklaruar për herë të parë gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në *mars 2013*. Në atë rast, me deklaratën periodike vjetore për vitin 2012, subjekti ka deklaruar *600.000 lekë "kesh në shtëpi"*.

d. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se nga vlera totale prej 41.600 eurosh, 20.000 euro janë paguar në datën 02.04.2013, me nënshkrimin e kontratës nga kursime të viteve, ndërsa 11.600 euro në datë 28.06.2013 [pa specifikuar burimin]. Përgjigjet e pyetësorit nr. 2 janë në linjë me pyetësin nr. 1, por me ndryshimin që tashmë 11.600 euro subjekti i ka deklaruar se janë derivat i shumës *"1.100.000 lekë dhuruar nga mamaja në vitin 2009"*, nga *"pensioni i patërhequr dhe i akumuluar që prej vitit 1997 deri në vitin 2009"*.

e. Në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit në Komision, subjekti ka deklaruar se pagesa prej 31.000 eurosh për apartamentin ka si burim: vlerën prej 600.000 lekësh deklaruar si gjendje *cash* në vitin 2012, vlerën prej 1.000.000 lekësh që ka pasur në shtëpi, dërguar nga i vëllai [për të bërë shtesën e shtëpisë, e cila nuk u bë asnjëherë] dhe pjesa tjetër është paguar nga *të ardhurat e vitit*, si dhe kursimet ndër vite, të cilat *gabimisht* nuk i ka shënuar në deklaratimet vjetore pranë ILDKPKI-së.

f. Ndryshe nga sa më sipër referuar, në seancën publike të zhvilluar në Komision, në datën 19.04.2021, subjekti ka parashtruar se pagesa e 31.600 eurove mbulohet nga 5.000 euro të kursyera në vitet 2010 dhe 2011, *1.386.817 lekë* nga i vëllai dhe kursime nga vitet 2012 dhe 2013. Me fjalë të tjera, në atë rast, subjekti nuk deklaroi më vlerën prej 1.000.000 lekësh nga i vëllai, por e referon të shtuar dhe shton edhe kursime të tjera të padeklaruara.

⁵⁵ Nr. {***} rep., nr. {***} kol.

g. Subjekti po ashtu deklaroi se vlerën prej 9.985 eurosh ia ka shlyer vëllait me tërheqjen e kryer në llogarinë bankare, ku ishin të depozituara paratë që i kishte dhuruar më parë nëna, përkatësisht 4.985 euro në vitin 2014 dhe pjesën tjetër prej 5.000 eurosh në vitin 2017-2018. Ky pretendim bie ndesh me shpjegimet e saj të mëparshme. Konkretisht, në pyetësin nr. 3, e pyetur për shumën 9.985 euro, mbërritur me transfertë në llogarinë e subjektit nga Italia, më 19.07.2011, ajo u shpreh se këtë shumë e ka dërguar vëllai dhe bashkëshortja e tij për shtesën anësore dhe restaurimin e apartamentit të prindërve, por duke qenë se këto punime nuk u realizuan, *në muajt në vazhdim* kur erdhi në Shqipëri, vëllai e rimori përsëri shumën e sipërcituar me vete.

h. Nga aktet bankare rezulton se subjekti ka tërhequr shumën 10.000 euro nga llogaria në Raiffeisen Bank në datën 28.03.2014. Me fjalë të tjera, fondet kanë qëndruar të paprekura 10 muaj, pasi është kryer pagesa e kështit të dytë [në maj 2013, sipas kontratës së sipërmarrjes].

12.9. Nga sa më sipër, rezultojnë disa fakte të pakontestueshme. *Së pari*, subjekti ka ndryshuar vazhdimisht shpjegimet për sa i përket origjinës së fondeve të përdorura prej saj si burim për pagesën e vlerës 31.600 euro në prill e maj 2013. Këto ndryshime konsistojnë qoftë në burimin e të ardhurave, ashtu edhe vlerën që përfaqëson secili prej tyre. *Së dyti*, deri në 18 mars 2013, që përkon për pak javë me pagesën e kështit të parë për këtë pasuri, subjekti nuk ka deklaruar kursime jashtë sistemit bankar. *Së treti*, një vit më pas, në deklaratën periodike për vitin 2013, hartuar në 29 mars 2014, subjekti ka prezantuar për herë të parë ekzistencën e një sasive kursimesh të mjaftueshme për të mbuluar pagesat e kryera prej saj për të krijuar pasurinë objekt analize.

12.10. Për sa më sipër, i vetmi shpjegim i arsyeshëm i deklarimit të një sasive të konsiderueshme likuiditetesh në këtë moment kohor, në mars 2014, dhe në mospërputhje të dukshme me deklaratimet e mëparshme për këtë zë [likuiditetesh jashtë sistemit bankar], është nevoja e momentit që ka pasur subjekti për të shpjeguar pagesën e një vlere të konsiderueshme, sikurse është 31.600 euro brenda një harku kohor prill-maj 2013. Kolegji ka arsyetuar gjerësisht në vendime të mëparshme rëndësinë që marrin deklaratimet e kursimeve në deklaratat periodike vjetore, në kushtet që përbëjnë të vetmen provë në procesin e rivlerësimit, në mungesë të dokumentacionit apo të dhënave të tjera që do të lejonin të superohet mungesa e gjurmueshmërisë⁵⁶.

12.11. Në rrethanat konkrete, subjekti ka prezantuar një shumë kursimesh të ruajtura jashtë sistemit bankar që kapërcen në mënyrë të konsiderueshme të vetmen vlerë kursimesh të deklaruar deri në atë moment, 600.000 lekë. Për rrjedhojë, edhe parë në këtë dritë, pretendimi i subjektit është i pabesueshëm, pasi më shumë sesa realitetin e kursimeve të krijuara prej saj, ndër vite, ka për synim justifikimin e krijimit të pasurisë në momentin kur ka kryer pagesat. Duke mbajtur në konsideratë edhe sa rezulton nga shpjegimet e saj kontradiktore në proces për burimin nga vjen pjesa tjetër e fondeve të përdorura për këto dy pagesa – qoftë si dhurim nga pensioni i nënës, që në fakt është tërhequr thuajse një vit më pas, apo nga një fond likuiditetesh

⁵⁶ Ndër të tjerë, shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 4/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj; vendimin e Kolegjit (JR) nr. 27/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Peka; vendimin e Kolegjit (JR) nr. 47/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Selim Kryeziu; si dhe vendimin e Kolegjit (JR) nr. 18/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Flutura Skënderi.

të vëllait, për të cilin ka shpjegime të ndryshme në momente të ndryshme të procesit – trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit për *harresë* deklarimi kursimesh janë të pabazuara në kërkesat e ligjit, por edhe të pabesueshme.

12.12. Për rrjedhojë, në kushtet që subjekti ka deklaruar vetëm 600.000 lekë *cash* kursime, dhe burimi tjetër i deklaruar konfirmohet të jetë tërhequr vetëm nëntë muaj më pas, edhe në analizën e kryer në Kolegji, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme, pavarësisht korrektimit të kryer duke shtuar burimet e ligjshme të disponuara nga subjekti deri në datën e pagesës së këstit të parë. Nga kjo analizë, balanca negative prej (-) 2.204.200 lekësh do të zbutet në (-) 1.961.722 lekë, pasi përlllogaritet edhe vlera e kursimeve të deklaruara gjendje deri në 31 dhjetor 2012.

12.13. Kësti i dytë për shlyerjen e kësaj pasurie, në vlerën 11.600 euro, është paguar më 28.06.2013. Pasi ka analizuar dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit se këtë vlerë ia ka dërguar vëllai, Komisioni ka konstatuar se në referim të deklaratave periodike/vjetore dhe nga nxjerrja e llogarive bankare, rezulton që në fakt subjekti të ketë konvertuar në euro fondet që i ka dhuruar nëna, të cilat më 02.08.2010, i ka depozituar në Raiffeisen Bank deri në maj 2014. Për rrjedhojë, pagesa e këstit të dytë në datën 27.06.2013 nuk mund të ketë si burim këtë fond që ka qëndruar i paprekur në bankë deri nëntë muaj më pas. Referuar pikës 4.9 të vendimit, rezulton qartë që Komisioni i ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit gjatë gjithë procesit. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për të kundërtën janë të pambështetura në dokumentacion. Komisioni ka referuar edhe që subjekti ka qenë kontradiktore në shpjegimet në proces krahasuar me deklaratimet periodike vjetore, duke vënë në dukje kontradiktën në shpjegimet e subjektit në pyetësorët e ndryshëm për sa i përket burimit të krijimit të shumës 1.100.000 lekë dhe si është menaxhuar shuma tjetër e dërguar nga i vëllai dhe e shoqja.

12.14. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti nuk arriti t'i shpjegojë kontradiktat në këto shpjegime edhe nëpërmjet ankimit të ushtruar. Për rrjedhojë, balanca negative e konstatuar në Komision për këstin e dytë konfirmohet edhe në analizën e kryer në Kolegji. Në kushtet kur si burim të mundësimit të kësaj pagese subjekti deklaroi një fond likuiditetesh të cilin në fakt nuk e ka përdorur – tërheqjen e pensionit të nënës -- dhe nga ana tjetër, pretendimi për kursime të vitit, sikurse arsyetuar gjerësisht më sipër, nuk ka gjetur asnjë pasqyrim në akte të kohës dhe duket si një përpjekje e kryer në funksion të përmirësimit të situatës financiare, konkluzioni i Komisionit u vlerësua i bazuar. Në këto kushte, edhe sipas kontrollit të analizës në Kolegji, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Vlera e balancës negative prej (-) 1.626.436 lekësh për pagesën e këtij kësti, u konfirmua edhe në analizën e kryer në Kolegji.

12.15. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se nuk është e bazuar e, për pasojë, e pazbatueshme në rastin e saj, analogjia me një vendim të mëparshëm të Komisionit, për sa i përket pretendimeve për kursime në *cash* të ngritura për herë të parë në proces, duke referuar vendimin e Komisionit nr. 105/2019. Së pari, ai vendim i Komisionit nuk i është nënshtruar kontrollit të Kolegjit. Së dyti, referuar përmbajtjes së tij, publikuar në faqen zyrtare të

Komisionit⁵⁷, edhe situata faktike duket e ndryshme, në kushtet që ai subjekt rivlerësimi [Elsa Toska], ka deklaruar një sasi likuiditetesh *cash* në deklaratën *vetting*, për të cilën i është kërkuar të justifikojë burimin e krijimit. Në rastin në shqyrtim, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* që nga viti 2003 – 2012, kur krijoi pasurinë, ndërsa kursimet *cash* prezantohen si nevojë e justifikimit të pagesave të kryera, dhe nuk rezultojnë asnjë qartësim i situatës edhe në deklaratën *vetting*, e nuk duket se mund të argumentohet as për analogji teorike. Për këto arsye, edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar, përveçse pa peshë përcaktuese në zgjidhjen e çështjes së subjektit.

12.16. Në konkluzion të analizës së pretendimeve në ankim për apartamentin me sipërfaqe 102 m², ndodhur në {***}, Durrës, blerë në vitin 2013, në referim të fashikujve të krijuara në Komision, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit është gjendur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

D. Për analizën financiare të kryer nga Komisioni

13. Në përfundim të vendimit, Komisioni ka përfshirë një analizë financiare të periudhës 2003-2016, për të cilën *nuk* ka një vlerë përmbledhëse apo konkluzion, ndonëse mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve është konkluzioni mbi të cilin është bazuar shkarkimi nga detyra. Sikurse referuar edhe më sipër, në kontrollin e vendimit, sipas shkaqeve të ankimit, trupi gjykues u referua në shumatoren e përlllogaritur në Kolegj të vlerave të pasqyruara në tabelën e vendimit në faqen 23. Prej kësaj table, subjekti rezultojnë me një balancë negative nga tabela në totalin prej (-) 4.070.996 *lekësh*. Kjo vlerë rezultojnë të jetë pasqyrim i një sërë shpjegimesh të subjektit në prapësim të rezultateve të hetimit, si pasojë e të cilave balanca fillestare u reduktua ndjeshëm⁵⁸. Duke iu kthyer vendimit objekt ankimi, vitet me balancë negative rezultojnë të jenë tetë (8)⁵⁹. Po ashtu, nga përmbajtja e vendimit, balancat negative për krijimin e pasurive e mbulimin e shpenzimeve, të përlllogaritura në momentet përkatëse kur këto veprime kanë ndodhur, kanë rezultuar në Komision në një vlerë që si shumatore total do të ishte në shumën (-) 6.129.054 *lekë*⁶⁰.

13.1. Në ankim, subjekti pretendon se rezultati total është pozitiv në vlerën 3.103.893 *lekë*. Sipas saj, të ardhurat e ligjshme mbulojnë dhe tejkalojnë detyrimet dhe shpenzimet e kryera për këtë periudhë. Komisioni ka përlllogaritur në mënyrë të pasaktë disa zëra, përfshirë *tarifën* e doktoratës në vitet 2009-2010, që sipas subjektit duhet të konsiderohet shpenzim i vitit 2009, ndërsa pjesa e mbetur paguhej në këste në tri vitet në vijim. Në total, vlera e ankimit për këtë

⁵⁷ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/03/Vendim-Elsa-Toska.pdf>.

⁵⁸ Në rezultatet paraprake të hetimit, Komisioni ka evidentuar se për periudhën 2003 - 2016 subjekti paraqitet me një mungesë burimesh të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe për krijimin e aseteve, në total në shumën (-) 7.658.204 *lekë*.

⁵⁹ Konkretisht, vitet 2005, 2007, 2008, 2010, 2012, 2013, 2015 dhe 2016. Viti 2007 rezultojnë me një balancë negative të papërfillshme prej 6.505 *lekësh*.

⁶⁰ Konkretisht, nga përmbajtja e vendimit: Për pasurinë shtëpi banimi në Durrës, në periudhën 2003-2008, balanca negative rezultojnë (-) 571.974 *lekë*. Për pasurinë automjet blerë në datën 29.01.2010, balanca negative rezultojnë (-) 1.184.602 *lekë*. Për pasurinë apartament në {***}, në vitin 2013, balanca negative rezultojnë (-) 3.830.636 *lekë*. Për vitet 2012, 2015 dhe 2016, ka rezultuar me balancë negative në shumën totale (-) 541.842 *lekë*, për të përballuar shpenzimet.

zë është 416.430 lekë. Po ashtu, sipas subjektit, Komisioni ka llogaritur në mënyrë të pasaktë *shpenzimet e jetesës për disa vite* [2014, 2015 dhe 2016]. Subjekti pretendon se këto shpenzime nuk përfaqësojnë shpenzimet *reale* të saj dhe nuk duhet të tejkalojë nivelin e shpenzimeve jetike të vitit 2013, pasi ajo ishte njëri i vetëm. Për sa i përket analizës financiare të kryer për vitet 2004-2012, subjekti kërkon nga Kolegji të merren në konsideratë disa prova të reja, për të mbështetur pretendimin se në këto vite, në llogarinë e saj bankare janë kredituar pagesat e *pensionit të nënës*, e cila nuk kishte një llogari bankare të vetën. Këto vlera, sipas subjektit, kanë sjellë diferenca negative të pavërteta në rezultatet financiare të viteve përkatëse. Për këtë arsye, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, duhet të korrigjohet zëri i diferencës në likuiditete, duke i zbritur ndikimin e të ardhurave të pensionit të nënës të kredituar në llogari nga viti 2004 deri në vitin 2012.

13.2. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka përcjellë edhe një analizë financiare nga e cila ajo rezulton me një balancë negative të papërfillshme në vitin 2008 dhe (-) 675.445 lekë në vitin 2013. Në aktet që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit [analizuar edhe në hyrje të vendimit], subjekti nuk paraqiti provë të re në lidhje me sa referon. Si provë të re ajo ka cituar shkresën e hyrje-daljeve nga dhe në Shqipëri të vëllait të saj e nxjerrë nga sistemi *TIMS*, si dhe tabelën financiare. Këto akte u vlerësua se nuk përmbajnë shkaqe për t'i marrë në cilësinë e provës së re në ankim, pasi jo vetëm nuk përmbushin kriteret ndaluese të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, por gjithsesi nuk paraqesin të dhëna që do të ishin të nevojshme në vendimmarrje, parën nën dritën e dispozitave të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016

13.3. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara edhe për këtë konkluzion të Komisionit. Ky vlerësim mban në konsideratë disa aspekte. *Së pari*, sikurse arsyetuar gjerësisht më sipër, subjekti rezulton me pamundësi financiare të konsiderueshme për krijimin e pasurive në momentet e krijimit të tyre. Këto pamundësi e balanca negative qëndrojnë pavarësisht nga pranimi i pabazuar në ligj i shumë pretendimeve deklarative të subjektit nga Komisioni. *Së dyti*, më së paku për periudhën e rivlerësimit, për të cilën subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin periodik vjetor të pasurisë, verifikimi duhet të kryhet për çdo vit dhe në momentin e krijimit të secilës pasuri. Bilanci total i një periudhe të gjatë nuk tregon korrektësisht mundësinë financiare të subjektit në momente të caktuara. Për këtë arsye, ky pretendim nuk qëndron edhe në nivel parimor. *Së treti*, dhe përpos sa është ritheksuar më sipër në këtë paragraf, për qëndrimin favorizues të treguar për subjektin nga Komisioni, nga analiza dhe aktet në fashikull, rezulton po ashtu se për vitin 2013, i cili ka balancën negative më të spikatur, në vlerën (-) 2.062.261 lekë në tabelën përfundimtare, analiza e kryer nga Komisioni ka një gabim *konceptual* që *favorizon* subjektin e rivlerësimit në mënyrë të ndjeshme. Konkretisht, Komisioni e ka përlllogaritur vlerën e apartamentit 31.600 euro dhe detyrimin e pashlyer 10.000 euro, duke e ngarkuar për pasojë subjektin në analizën vjetore vetëm për 21.600 euro dhe jo gjithë vlerën e shlyer. Nëse analiza do të kryhej saktë, vlera e shlyer nga subjekti do të duhet t'i ishte ngarkuar e plotë, por pa përfshirë këstin e papaguar. Nga kjo përlllogaritje në përputhje me parimet e kontabilitetit, balanca negative [vjetore] do të ishte (-) 3.464.361 lekë.

13.4. Gjithsesi, në zbatim të garancive procedurale të subjektit me ankimin, vendimi i Kolegjit u bazua vetëm në vlerat e konstatuara nga Komisioni. Ky konstatim u çmua me rëndësi vetëm

për të plotësuar panoramën e situatës së analizës financiare të kontestuar gjerësisht nga subjekti i rivlerësimit dhe si vlerësim edhe i analizës financiare të sjellë nga subjekti bashkë me ankimin.

13.5. Për sa i përket zërave të tjerë të potencuar në mënyrë të shprehur në ankim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pagesa e kryer nga subjekti për tarifën e studimeve në shkollën e doktoratës për vitet 2009-2011 është 3.000 euro⁶¹. Këtë vlerë subjekti pretendoi se e pagoi në vitin 2009, ndërsa për vitet e tjera nuk ka kryer pagesë, pasi përfitoi bursë. Në kushtet kur bursa u akordua në fund të vitit 2009⁶², vlera 3.000 euro e vendosur si shpenzim i shlyer në vitin 2010, duket më e arsyeshme siç është vendosur nga Komisioni, me arsyetimin se përgjithësisht pagesat e tarifave të shkollimit, në kushtet e kërkesave për bursë, kryhen pas kthimit të përgjigjeve të bordeve universitare për akordimin e bursës dhe masën e tyre. Subjekti nuk ka paraqitur prova apo akte të institucionit, rreth mënyrës sesi kërkohej shlyerja e kësteve. Për këto arsye, pretendimi i subjektit se tarifa e shkollës në total paguhej në tri këste, mbetet deklarative, kjo edhe për faktin se vërtetimi i institucionit nuk përmban të dhëna në këtë drejtim. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se vlera 3.000 euro është shlyer në vitin 2009 vjen në kundërshtim me dokumentacion e administruar.

13.6. Për sa i përket pretendimeve me fokus zbritjen e një pjese të *shpenzimeve të jetesës* për vite të caktuara, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka përlogaritur vlerat e referuara nga INSTAT. Pretendimi i subjektit për shpenzime më të ulëta se standardi mbetet në nivel deklarativ e nuk provohet me dokumentacion. Për pasojë, nën dritën edhe të arsyetimeve të mëparshme të Kolegjit me objekt këtë zë shpenzimesh, trupi gjykues e vlerëson të panevojshme të ndalet më tepër në këtë shkak ankimi.

13.7. *Së fundmi*, kërkesa për korrigjimin e zërave/diferencës së likuiditeteve ndër vite, që u përfshinë nga Komisioni në analizën financiare e që përfshin pensionin e nënës që derdhej në llogarinë bankare të subjektit, është ngritur për herë të parë në ankim. Në mënyrë alternative, trupi gjykues vëren se edhe nëse ky pretendim do të ishte trajtuar nga Komisioni, në kushtet kur llogaria bankare ishte në emër të subjektit, këto vlera natyrshëm afektojnë gjendjet e likuiditeteve të saj në bankë. Duke pasur parasysh se subjekti pretendon se e ka përfituar ajo gjithë pensionin e akumuluar të nënës, ky pretendim është i pabazuar dhe i pakuptimtë.

13.8. Në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të kryera. Në vijim të konstatimeve në këtë vendim, duke qenë se subjekti i rivlerësimit rezulton me një mungesë burimesh të ligjshme të konsiderueshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe për të përballuar shpenzimet, pretendimet në drejtim të kundërshtimit të *analizës financiare* të kryer nga Komisioni u vlerësuan të pabazuara.

13.9. Në përmbledhje të sa më sipër, Kolegji, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Bilo, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Për pasojë, nën dritën e pikës 1 dhe

⁶¹ Sipas vërtetimit të pagesës lëshuar nga Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, datë 04.12.2019.

⁶² Referuar vendimit të datës 28.12.2009, sipas së cilit Universiteti Ndërkombëtar i Strugës i njehej subjektit bursë në masën 70%.

3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit pamjaftueshëm. Për sa më lart, vendimi nr. 370, datë 18.05.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të neni 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 370, datë 18.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Bilo.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 09.05.2024.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi